



Kingdom of the Netherlands

Vlerësimi i performancës së Gjykatave të Posaçme dhe SPAK në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar për vitin

2022





Kingdom of the Netherlands

DOKUMENT POLITIKASH

Vlerësimi i performancës së Gjykatave të Posaçme dhe SPAK në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar për vitin 2022

Authorë

Jonida Jani
Arjan Dyrmishi

Rishikim i brendshëm

Mirsada Halluni

Design and layout

Ergys TEMALI

Images

freepik.com

CSDG

Dhjetor 2023



© Dhjetor 2023, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG)

Mirënjohje

Ky është dokument i përgatitur nga Qendra për Studimin e Demokracisë edhe Qeverisjes në kuadër të projektit: “Përmirësimi i Debatit të Politikave dhe Llogaridhënies në Përbushjen e Grupit të Parë të Kapitujve Negociues (Cluster 1), përmes Krijimit të Platformës së Negociatave BE-Shqipëri për Cluster 1 (C1-EU-NPA)”, mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë

Përgjegjësitë

Opinionet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë dokument janë të autorit/ve dhe nuk reflektojnë opinionet apo pikëpamjet e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë.

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave.....	5
Lista e grafikëve.....	5
Lista e shkurtimeve.....	6
Përmbledhje ekzekutive.....	7
I: Hyrje	13
1.1 Konteksti.....	13
1.2 Qëllimi i dokumentit.....	15
1.3 Metodologjia	16
1.4 Mbledhja e të dhënave dhe kufizimet në zbatimin e metodologjisë	16
II: Vlerësimi i përmbushjes së prioriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar	19
2.1 Produktiviteti.....	19
2.2 Efiçenca	24
2.2.1 E drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm	25
2.2.2 Kohëzgjatja e çështjeve për korrupsionin dhe krimin e organizuar	26
2.2.3 Track records dhe sistemi i integruar për menaxhimin e çështjeve	27
2.3 Relevanca.....	28
2.3.1 Procedimet penale dhe ndëshkimet për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë	29
2.3.2 Sekuestrimi dhe konfiskim i aseteve kriminale që rezultojnë nga vepra të lidhura me korrupsionin	34
III: Transparenca.....	35
3.1 Kuadri ligjor ku mbështetet disponueshmëria e vendimeve gjyqësore për publikun	37
3.2 Rëndësia e transparencës së proceseve gjyqësore	39
3.3 Aksesin në kopjet e vendimeve gjyqësore dhe mbrojtja e të dhënave personale.....	42
3.4 Digjitalizimi i munguar	44
3.5 Ngarkesa në punë e gjyqtarëve.....	46
3.6 Inspektimet tematike për mospublikim të vendimeve	47
3.7 Institucionet përgjegjëse për monitorimin e transparencës	49
IV: Konkluzione dhe rekomandime	51
Bibliografia.....	54
Shtojcat	58

Lista e tabelave

Tabela 1: Indikatorët e përdorur për të vlerësuar procedimet penale në fushën e korrupsionit dhe krimin të organizuar	18
Tabela 2: Numri i procedimeve penale të hetuara nga Prokuroria e Posaçme (2020-2022)	19
Tabela 3: Numri i personave nën hetim nga Prokuroria e Posaçme (2020-2022) ...	20
Tabela 4: Treguesit e mënyrës së përfundimit të procedimeve penale (2020-2022)	20
Tabela 5: Veprat penale me më shumë çështje të gjykuara nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	23

Lista e grafikëve

Grafiku 1: Mënyra e përfundimit të procedimeve penale sipas grup-veprave penale (2020-2022)	21
Grafiku 2: Backlog-u dhe çështjet e reja të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (2020-2022)	24
Grafiku 3: Indeksi i perceptimit të korrupsionit	29
Grafiku 4: Numri i çështjeve të dërguara për gjykim nga SPAK (2020-2022)	30
Grafiku 5: Numri i të pandehurve (2020-2022)	31

Lista e shkurtimeve

AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
BE	Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
CEPEJ	Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
CCJE	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë
DUDNj	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
GRECO	Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit
GJKKO	Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
ICMS	Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Çështjeve
KE	Këshilli i Evropës
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
OFL	Operacioni “Forca e Ligjit”
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
PNDKP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
RCC	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar
SIENA	Aplikacioni i Sigurt i Rrjetit të Shkëmbimit të Informacionit të Europolit

Përmbledhje ekzekutive

Më 25 mars të vitit 2020, Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë duke përcaktuar se para konferencës së parë ndërqeveritare, vendi duhet të siguronte “vazhdimin e implementimit të reformës së shtetit gjyqësor dhe të finalizonte ngritjen e strukturave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”.¹ Konferenca e parë ndërqeveritare me Shqipërinë u mbajt në 19 korrik të vitit 2022, e ndjekur menjëherë nga shqyrtimi i përputhshmërisë së *acquis* të BE-së, i njohur si procesi screening,² i cili përfundoi në muajin nëntor të këtij viti.³

Metodologjia e re e zgjerimit e publikuar në shkurt të vitit 2020,⁴ theksoi se shteti i së drejtës, të drejtat themelore, funksionimi i institucioneve demokratike, reforma në administratën publike dhe kriteri ekonomik përbëjnë bërthamën e asaj që njihen si “themeloret” e procesit të anëtarësimit në BE.⁵ “Çështjet themelore” do të shërbejnë si “rojtare të progresit” para se të merren në konsideratë reformat e tjera.⁶ Në këtë aspekt, BE thekson se konsolidimi i shtetit të së drejtës kërkon një sistem gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe llogaridhënës, i cili vepron me efikasitet, duke pasur burimet e duhura në dispozicion, i lirë nga ndërhyrjet.⁷ Zbatimi dhe thellimi i reformës së sistemit gjyqësor në Shqipëri shihet si një garanci për respektimin e parimit të shtetit të së drejtës, karakteristikë thelbësore e vendeve demokratike. “Shteti i së drejtës vepron si një thikë me dy presa, që nga njëra anë garanton mbrojtjen e të drejtave dhe nga ana tjetër thekson llogaridhënien”.⁸

Por nga ana tjetër, sistemi gjyqësor nuk është mbi ligjin pasi ata që gjykojnë dhe ata që gjykohen duhet të mbahen njësoj përgjegjës para tij. Në një kuptim të gjerë, sistemi gjyqësor duhet të jetë përgjegjës para shoqërisë së cilës i shërben.⁹ Nga njëra anë,

¹ Këshilli i Bashkimit Evropian, 7002/20, fq. 4. <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf>

² Komisioni Evropian, (2023), Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komisionin Ekonomik e Shoqëror Evropian dhe Komisionin e rajoneve, fq. 4. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/2023-communication-eu-enlargement-policy_en

³ <https://www.kryeministria.al/procesi-screening/>

⁴ https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/statement_20_208

⁵ Komisioni Evropian, (2023), Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komisionin Ekonomik e Shoqëror Evropian dhe Komisionin e rajoneve, fq. 8. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/2023-communication-eu-enlargement-policy_en

⁶ Sam van der Staak, (2023), Një fotografi e demokracisë në raportet e zgjerimit të vitit 2023, <https://www.idea.int/news/snapshot-democracy-2023-enlargement-reports>

⁷ Komisioni Evropian, (2023), Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komisionin Ekonomik e Shoqëror Evropian dhe Komisionin e rajoneve, fq. 8. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/2023-communication-eu-enlargement-policy_en

⁸ Roger K. Warren, Rëndësia e pavarësisë së gjyqësorit dhe llogaridhënien, <https://ncsc.contentdm.oclc.org/digital/collection/judicial/id/207/>

⁹ Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), Opinion Nr. 18 (2015), Pozicioni i gjyqësorit dhe marrëdhëniet e tij me pushtetet e tjera në një demokraci moderne. [https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=CCJE\(2015\)4&Language=lanEnglish&Ver=original&BackColorInternet=DBDCF2&BackColorIntranet=FDC864&BackColorLogged=FDC864](https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=CCJE(2015)4&Language=lanEnglish&Ver=original&BackColorInternet=DBDCF2&BackColorIntranet=FDC864&BackColorLogged=FDC864)

shoqëria pret që gjyqësori të ndërmarrë veprime ndaj gjyqtarëve të cilët përfshihen në veprime të cilat i shkelin këto vlera. Nga ana tjetër, gjyqësori jep llogari para shoqërisë për të siguruar që të gjitha vendimet janë të pavarura dhe të paanshme, të dhëna me integritet dhe të pa ndikuara nga politika apo faktorë të tjerë të cilat çojnë në vendime të korruptuara.

Në këtë kontekst, gjykatat duhet të veprojnë në mënyrë transparente, “duke dhënë shpjegime për vendimet dhe procedurat” me qëllim garantimin e llogaridhënies.¹⁰ Kjo formë e llogaridhënies, e përkufizuar si “llogaridhënia shpjeguese”,¹¹ ka interesin publik në themel të saj dhe mban të hapura institucionet e drejtësisë ndaj kritikave konstruktive dhe përpjekjeve për përmirësim të vazhduar. Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies shërben kështu për të rritur besimin e publikut ndaj sistemit gjyqësor.

Ndërkohë, metodologjia e re e zgjerimit, njeh rolin aktiv të organizatave të shoqërisë civile në procesin e anëtarësimit në BE, ku “çështjet themelore” kanë prioritet.¹² Në këtë kontekst, roli i shoqërisë civile është thelbësor për të siguruar që procesi i integritetit në BE të jetë transparent, gjithëpërfshirës dhe i përgjegjshëm. Organizatat e shoqërisë civile janë vëzhgues kritikë të cilat promovojnë të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit, si dhe mbajnë autoritetet përgjegjëse. Për më tepër, organizatat e shoqërisë civile mund dhe duhet të kontribuojnë në çështje që lidhen në veçanti me korrupsionin në sistemin gjyqësor duke “monitoruar incidencën dhe treguesit e mundshëm të korrupsionit si vonesat në publikimin e vendimeve dhe cilësinë e vendimeve të publikuara”.¹³

Monitorimi sistematik i veprimtarisë së institucioneve të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK dhe Gjykatat), që po përmbyllin vitin e katërt të veprimtarisë së tyre, shërben jo vetëm për të vlerësuar efektivitetin e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar por edhe për të vlerësuar performancën e vetë institucioneve, siguruar transparencën, si dhe për të identifikuar mangësi dhe problematika të cilat kanë nevojë për t’u adresuar.

Në këtë aspekt, sikurse është theksuar vazhdimisht edhe nga Komisioni Evropian, “zhvillimi i një historiku rezultatesh (track records) lidhur me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar të të gjitha niveleve, përfshirë nisjen e procedimeve ndaj

¹⁰ Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), Opinion Nr. 24 (2021), Evoluimi i Këshillave Gjyqësor dhe roli i tyre në sistemet gjyqësore të pavarura dhe pananshme. <https://rm.coe.int/opinion-no-24-2021-of-the-ccje/1680a47604>

¹¹ Po aty

¹² Fjalimi i komisionerit Várhelyi në seancën plenare të 580-të të Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social - Debat mbi të ardhmen e shoqërisë civile në procesin e zgjerimit https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/speech_23_3827

¹³ Transparenca ndërkombëtare, (2007), Forcimi i transparencës së gjyqësorit, fq. 4. https://images.transparencycdn.org/images/TI_Policy_Position_Judiciary_01.07.pdf

zyrtarëve të lartë publik do të mbetet një nga treguesit kryesorë për përparimin në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian”.¹⁴

Në këtë kontekst, për të tretin vit radhazi, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) analizon dhe vlerëson performancën e institucioneve të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Vlerësimi i institucioneve të posaçme bazohet në një numër indikatorësh të matshëm në përputhje me specifikat dhe problematikat e çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar të hetuara dhe gjykuara nga Prokuroria dhe Gjykatat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Indikatorët masin tre dimensionet kryesore përkatësisht: (i) produktivitetin, (ii) efikasitetin dhe (iii) relevancën, mbi bazën e të cilave vlerësohet efektiviteti i përgjigjes ndaj fenomeneve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në Shqipëri.

Falë përditësimit sistematik të informacioneve nga institucionet e marra në shqyrtim si dhe falë vënies në dispozicion në kohë dhe me cilësi të informacioneve dhe të dhënave të kërkuara nga stafi i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dy raportet e mëparshme (2020, 2021), kanë bërë një vlerësim sasior dhe cilësor të të tre dimensioneve të mësipërme. Por, ndryshe nga dy raportet e mëparshme, hartimi i këtij raporti është cënuar nga mungesa e të dhënave. Në faqen zyrtare të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në rubrikën këndi i informimit (çështje të përfunduara/dosje penale) vendimi i fundit i publikuar mban datën 27.07.2022, vendim për çështjen numër 100. Që prej kësaj date, për një vit e gjysmë nuk ka vendime të publikuara në faqen zyrtare të kësaj gjykate. Nga ana tjetër, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk ka bërë publike ndonjë raport vjetor të punës për vitin 2022.

Përveç të dhënave të marra nga faqen zyrtare të GJKKO, në vitet e mëparshme, përmes zbartimit të të drejtës së informimit, CSDG ka marrë dhe ka analizuar në mënyrë të hollësishme edhe vendimet e plota. Nga Gjykata janë vënë në dispozicion (i) kopje të vendimeve të anonimizuara të GJKKO për vitin 2021, dhe (ii) të dhëna statistikore për çështjet e korrupsionit dhe krimit të organizuar për periudhën janar – dhjetor 2021.

Në të njëjtën mënyrë, edhe për këtë vlerësim të radhës, përmes një kërkesë zyrtare CSDG i ka kërkuar GJKKO-së vënien në dispozicion të vendimeve dhe të dhënave statistikore për çështje të korrupsionit dhe krimit të organizuar për periudhën korrik – dhjetor 2022, por të dhënat e kërkuara nuk i janë vënë në dispozicion. Në këtë kontekst, mungesa e të dhënave pengon dhënien e një vlerësimi të plotë dhe qartë të veprimtarisë dhe performancës së strukturave në fokus të raportit, dhe përbën kështu edhe kufizimin kryesor të këtij raporti.

¹⁴ Komisioni Evropian, (2023), Shqipëria Screening 2023, fq 51. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en

Përkundrejt kësaj situate, për të mundësuar analizën u bë kryqëzimi i të dhënave duke përdorur raportet e publikuara në faqet zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP).

Nga analiza dhe vlerësimi rezulton se:

- Rastet e hetimeve për çështje të korrupsionit të zyrtarëve të lartë shtetërorë mbeten në nivele të ulta (18 procedime penale me 18 të pandehur gjatë 2020 - 2022). Gjithashtu, vendimet e dënimit për ish-zyrtarë të nivelit të lartë mbeten të ulëta (4 vendime dënimi me 4 persona të dënuar gjatë vitit 2022).
- Organika e strukturave të posaçme ka vakanca të theksuara dhe numri i madh i çështjeve të marra në shqyrtim dhe kompleksiteti i tyre, rezulton në rënie të produktivitetit dhe efikasitetit si dhe në vonesa në arsyetimin dhe publikimin e vendimeve gjyqësore.
- Mungesa e transparencës shfaqet në pjesën dërrmuese të institucioneve të marra në shqyrtim, dhe kjo është shqetësuese. Disa prej institucioneve ofrojnë publikim të pjesshëm të të dhënave dhe disa nuk publikojnë asnjë informacion. Për më tepër, mungon harmonizimi i të dhënave mes institucioneve të ndryshme të sistemit të drejtësisë.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka marrë masa për të korrigjuar problematikat me transparencën dhe të monitorojë sistematikisht zbatimin e kuadrit ligjor dhe strategjik për transparencën.
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka kryer inspektime tematike lidhur me mospublikimin e vendimeve nga gjykatat e posaçme, si dhe nuk ka marrë ndonjë masë disiplinore apo tjetër ndaj institucioneve respektive për mospublikimin e vendimeve sipas legjislacionit dhe afateve të përcaktuara.
- Ministria e Drejtësisë, si institucioni përgjegjës për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 nuk ka ndërmarrë ndonjë hap apo masë për ta adresuar problemin e rënies së transparencës në dy vitet e fundit.
- Edhe Kuvendi nuk e ka indentifikuar apo ngritur si problem mungesën e transparencës gjatë raportimit vjetor të KLP, KLGJ, dhe ILD, çka tregon për një mungesë të fokusit dhe vëmendjes ndaj transparencës.
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjithashtu nuk i ka ushtruar kompetencat për monitorimin e zbatimit të transparencës sipas kërkesave të legjislacionit për të drejtën e informimit.¹⁵

¹⁵ Lgji nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit"

Kështu, rënia e shkallës së transparencës së institucioneve të posaçme të drejtësisë dhe mungesa e vëmendjes nga institucionet e tjera përgjegjëse ndaj kësaj tendence është gjetja më problematike e këtij raporti të tretë është. Ndërkohë, një sistem i hapur dhe transparent i drejtësisë është një parakusht për krijimin dhe ruajtjen e besimit të publikut në drejtësi.¹⁶ Për më tepër, aksesit në informacionin e gjykatave është i domosdoshëm për të parandaluar praktikën korruptive.¹⁷ Kjo rezulton në besimi të ulët të publikut në institucionet e drejtësisë. Besimit i ulët i publikut në institucionet e drejtësisë theksohet edhe nga raportet ndërkombëtare, ku nënvizohet se “besimi i publikut në institucionet gjyqësore është i ulët, korrupsioni në gjyqësor mbetet një problem serioz dhe dënimet e gjyqtarëve të rangut të lartë për korrupsion dhe abuzim me pushtetin janë historikisht të rralla.”¹⁸

Nga ana tjetër, rritja e transparencës së sistemit të drejtësisë theksohet edhe në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, ku nënvizohet objektivi për “fuqizimin e transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane”.¹⁹ Tregues i përmbushjes së qëllimit të mësipërm është “përqindja e çështjeve gjyqësore për të cilat informacioni bazë është në dispozicion në internet dhe i përditësuar”, dhe për këtë janë përcaktuar si institucione përgjegjëse KLGJ dhe gjykatat.²⁰

Për më tepër, Këshillit i Lartë Gjyqësor, në vendimi nr. 590, datë 26.11.2020, për miratimin e “Planit strategjik të komunikimit për sistemin gjyqësor” thekson angazhimin për rikthimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor, si një ndër objektivat e tij kryesorë.²¹ Përmes ofrimit të informacionit për publikun. Ndërkohë, ILD në “Planin strategjik dhe planin e veprimit për zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2022” konstaton se sistemit gjyqësor i mungon transparenca. Gjatë vlerësimit të rrishtit, ILD e ka listuar perceptimin negativ të publikut për sistemin e drejtësisë, njëkohësisht edhe tek dobësitë edhe tek kërcënimet.²² Kështu, ILD konstaton se sistemit gjyqësor i mungon transparenca, dhe që kjo transparenca e munguar përkthehet në besueshmëri më të ulët nga publiku.

Edhe vetë Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila siç u theksua më sipër, nuk i ka të publikuara në faqen e saj zyrtare të gjitha vendimet e

¹⁶ France, Guilherme. (2019), Transparenca e procedurave gjyqësore, Transparenca Ndërkombëtare, fq.3 <https://knowledgehub.transparency.org/helpdesk/transparency-of-court-proceedings>

¹⁷ Faafeng, Jo et, al, (2013), Drejt drejtësisë, Analizë e procesit civil në gjykatat e rrethëve gjyqësore, OSCE, fq.77.

¹⁸ <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2022>

¹⁹ VKM, Nr. 823, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 dhe të planit të saj të veprimit”.

²⁰ Po aty.

²¹ Këshilli i Lartë Gjyqësor, Vendim nr. 590, datë 26.11.2020, Për miratimin e “Planit Strategjik të komunikimit të sistemit gjyqësor”.

²² Inspektori i Lartë i Drejtësisë, “Plani Strategjik i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2022”, fq. 12.

dhëna për vitin 2022, në raportin e saj vjetor për të njëjtin vit thekson: “Një sistem gjyqësor që funksionon mbi bazën e parimit të pavarësisë, paanshmërisë, profesionalizmit, transparencës dhe barazisë së individëve para ligjit, meriton besimin e publikut!”²³ Por rritja e besimit të publikut mbetet një slogan bosh pasi vendimet e saj nuk i bëhen të njohura publikut ndaj të cilit pritet besim.

Nisur nga këto gjetje dhe konkluzione, raporti rekomandon:

- Për aq sa problematika është e lidhur me mungesat në organikën e gjyqtarëve sipas numrit të përcaktuar me ligj, brenda kufizimeve që kjo situatë krijon duhet që të shqyrtohen dhe merren masa që të adresohet produktiviteti dhe efienca në performancën e SPAK dhe GJKKO.
- Në tërësi duhet të rishikohet qasja dhe të merren masa që të përmirësohet transparenca dhe qasja e qytetarëve dhe e organizatave të shoqërisë civile ndaj vendimmarrjes së institucioneve gjyqësore, si një mekanizëm kryesor për promovimin e llogaridhënies dhe rritjen e besimit në sistemin gjyqësor.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të marrë masa për të korrigjuar problematikat me transparencën dhe të monitorojë sistematikisht zbatimin e kuadrit ligjor dhe strategjik për transparencën.
- Zbatimi me rigorozitet i kuadrit për transparencën duhet të jetë në fokus të vëmendjes edhe edhe nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për të kryer inspektime tematike lidhur me shkaqet dhe përgjegjësitë e mospublikimit të vendimeve nga gjykatat, si dhe marrjen e masa respektive për korrigjimin e pasojave dhe krijimin e kushteve për mospërsëritjen e problemit.
- Ministria e Drejtësisë, për aq sa e lejojnë kompetencat dhe përgjegjësitë edhe në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 duhet të bëjë përpjekjet që i takojnë në lidhje me transparencën.
- Të adresohen problemet e lidhura me teknologjinë e informacionit në sistemin gjyqësor, çka do të zbuste problemi me anonimizimin e vendimeve voluminoze gjyqësore të cilat kryen në mënyrë manuale nga GJKKO duke zvogëluar në këtë mënyrë kohën e publikimit të vendimeve gjyqësore. Kjo për masën në të cilën problematika lidhet me kohën dhe burimet.
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë zbatimit të transparencës në institucionet e drejtësisë.

²³ Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Analiza vjetore e punës 2022, fq. 17.

I: Hyrje

1.1 Konteksti

Shqipëria ka treguar të jetë një nga rastet më sfiduese të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, reformimit të administratës publike dhe gjyqësorit.²⁴ Korrupsioni është i përhapur gjerësisht, dhe Bashkimi Evropian ka bërë thirrje të vazhdueshme për implementimin rigoroz të masave kundër korrupsionit, veçanërisht atyre brenda sistemit gjyqësor.²⁵ Për më tepër, reformimi i sistemit gjyqësor është çelësi për anëtarësimet e vendeve të tjera në BE”.²⁶

Për të adresuar këto sfida, Shqipëria miratoi më 22 korrik 2016 reformën në drejtësi e cila solli dhe ndryshimin e një të tretës së Kushtetutës për të bërë të mundur zbatimin e kësaj reforme.²⁷ Ndryshimet i hapën rrugë procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve dhe gjykatësve (veting-u), si dhe ngritjes së strukturave të specializuara si Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH), për të adresuar problemet me korrupsionin dhe krimin e organizuar.²⁸

Në mars të vitit 2020, Këshilli i Bashkimit Evropian vendosi hapjen e negociatave të anëtarësimit për Shqipërinë.²⁹ Para konferencës së parë ndërqeveritare, u kërkuua që ndër të tjera Shqipëria të siguronte vazhdimin e zbatimit të reformës në drejtësi, të finalizonte ngritjen e strukturave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe të intensifikonte më tej luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.³⁰

Në vlerësimin e situatës, raporti i Komisionit Evropian “Shqipëria Screening 2023” vë në dukje se “kuadri legjislativ dhe institucional i Shqipërisë për anti-korrupsionin është pjesërisht në përputhje me legjislacionin e BE, por korrupsioni vijon të mbetet mbizotërues dhe masat e marra kanë në përgjithësi një ndikim të kufizuar, veçanërisht në sektorë vulnerabël”.³¹ Po i njëjti raport thekson se ndonëse ndaj zyrtarëve të lartë ka

²⁴ Hoxhaj, Andi, (2020), The EU Anti-Corruption Report, A Reflexive Governance Approach, Routledge, fq. 157.

²⁵ Freedom House, Liria në botë 2022, Shqipëria, <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2022>

²⁶ Hoxhaj, Andi, (2020), The EU Anti-Corruption Report, A Reflexive Governance Approach, Routledge, fq. 168.

²⁷ Po aty, fq. 168.

²⁸ Po aty, fq. 168.

²⁹ Këshilli i Bashkimit Evropian, (25 March 2020) 7002/20, fq. 4.

<https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf>

³⁰ Po aty, fq. 5.

³¹ Komisioni Evropian, (2023), Shqipëria Screening 2023, fq 52. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en

patur disa dënime përfundimtare për akuzat për korrupsion, deri më tani asnjë dënim nuk i është referuar klasifikimit të akteve të korrupsionit si krim i rëndë.³²

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se zbatimi i reformës në drejtësi mbetet një sfidë e madhe. Procesi i vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve është i ngadaltë.³³ Gjithashtu, ngritja e institucioneve të reja të drejtësisë eci me ritme të ngadalta dhe hasi vonesa të panevojshme³⁴. Problematika ekzistojnë edhe në fushën e aksesit të qytetarëve në drejtësi dhe efikasitetin e gjyqimit.³⁵ Është e domosdoshme të përqendrohemi në adresimin e këtyre sfidave dhe në përmirësimin e procesit të reformës së drejtësisë për të siguruar një sistem gjyqësor më efikas dhe transparent që t'i përgjigjet nevojave të qytetarëve.

Legjislacioni penal i Shqipërisë përgjithësisht është pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së.³⁶ Nërkojë, vendi ka zbatuar nëntë nga dhjetë rekomandimet e Grupit të Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO)³⁷ për veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv. Gjithashtu, kuadri legjislativ dhe institucional i Shqipërisë janë të përshtatshme për të siguruar zhvillimin e një historiku rezultatesh (track-record) solid në luftën kundër korrupsionit³⁸.

Megjithatë, vendi vijon të listohet si një ndër vendet me korrupsionin më të lartë në Evropë, referuar Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparencës Ndërkombëtare.³⁹ Komisioni Evropian shprehet se “pavarësisht disa përparimeve, përpjekjeve të shtuara dhe angazhimit politik në luftën kundër korrupsionit, ai mbetet një shqetësim serioz dhe rritja e dënimeve për zyrtarët e lartë mbetet një prioritet kryesor për të ndryshuar kulturën e mos ndëshkueshmërisë.”⁴⁰

Situata e korrupsionit në Shqipëri dhe sfidat për të arritur një sistem të drejtësisë së pavarur, llogaridhënës, të aksesueshëm, transparent dhe eficient⁴¹, kërkojnë një përpjekje

³² Po aty, fq 51.

³³ Vrumo, Gjergji et al., (2021), Zbërthimi i kapjes së shtetit në Shqipëri, Në shqyrtim i rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe ligjeve të bëra me porosi nga viti 2008 deri në 2020, Transparenca Ndërkombëtare dhe Insituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, fq. 8.

³⁴ Instituti i Studimeve Politike, (2018), Reforma në Drejtësi: 2018, Bilanci, Problematikat, Sfidat, fq. 4. <https://isp.com.al/wp-content/uploads/2019/01/REFORMA-NE-DREJTESI-ISP-RAPORT-2018.pdf>

³⁵ Vrumo, Gjergji et al., (2021), Zbërthimi i kapjes së shtetit në Shqipëri, Në shqyrtim i rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe ligjeve të bëra me porosi nga viti 2008 deri në 2020, Transparenca Ndërkombëtare dhe Insituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, fq. 8.

³⁶ Komisioni Evropian, (2023), Shqipëria Screening 2023, fq 52. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en

³⁷ Po aty, fq. 14.

³⁸ Komisioni Evropian, (2023), Shqipëria Screening 2023, fq 51 https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en

³⁹ Transparenca Ndërkombëtare, Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2022, <https://www.transparency.org/en/cpi/2022/index/alb>

⁴⁰ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2022, fq. 23. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

⁴¹ VKM, Nr. 823, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 dhe të planit të saj të veprimit”.

të vazhduar nga institucionet përgjegjëse. Një drejtësi e paanshme dhe transparente është thelbi i një shoqërie të lirë dhe demokratike.

1.2 Qëllimi i dokumentit

Metodologjia e rishikuar e zgjerimit thekson se lufta efektive kundër korrupsionit do të mbetet një nga treguesit kryesorë për përparimin e vendit në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.⁴² Për këtë arsye, sukcesi në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar do të duhet të jetë i matshëm dhe i bazuar në një sistem të konsoliduar të dhënash.

Në këtë kontekst, për të vlerësuar efektivitetin e masave në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, lind nevoja për përcaktimin e një qasje monitorimi dhe analize të konsoliduar, e cila duke matur dhe vlerësuar rezultatet e arritura përkundrejt objektivave, mund të kontribuojë në rritjen e mbështetjes së aktivitetit të institucioneve të posaçme, si dhe të përparimit të procesit të integritetit evropian të Shqipërisë në tërësi.

Ndaj, ky dokument politikash ka si qëllim kryesor që nëpërmjet monitorimit sistematik dhe të vazhdueshëm të veprimtarisë së institucioneve të posaçme, të ofrojë një vlerësim sa më të plotë, gjithëpërfshirës dhe objektiv të efektivitetit të luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, si një nga prioritetet kryesore për forcimin e zbatimit të ligjit në vend dhe përparimin e vendit në procesin e antarësimit në Bashkimin Evropian.

Në të njëjtën kohë, dokumenti synon të kontribuojë në përmirësimin e transparencës së institucioneve të posaçme dhe në identifikimin e çështjeve të tjera të qënësishme në funksion të përmirësimit të politikave penale në vend.

Në mënyrë më specifike, ky dokument politikash ka për qëllim:

1. Të nxisë diskutime mbi gjetjet në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar si dhe të hartojë rekomandime të nevojshme.
2. Të kontribuojë në diskutime në lidhje me qasjen dhe mekanizmat për vlerësimin e performancës së institucioneve të posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.
3. Të nxisë diskutime mbi rëndësinë e transparencës së sistemit gjyqësor.
4. Të nxisë bashkëpunimin, ndërveprimin dhe përfshirjen e institucioneve me qëllim përmirësimin e vlerësimit të performacës.

⁴² Komisioni Evropian, (2020), Përmirësimi i procesit të anëtarësimit – Një perspektivë e besueshme Evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enhancing-accession-process-credible-eu-perspective-western-balkans_en

5. Të nxisë angazhimin e grupeve të interesit për të identifikuar dhe adresuar problematika dhe çështje me rëndësi.

1.3 Metodologjia

Ky raport vlerësimi në lidhje me ecurinë e çështjeve të hetuara nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) dhe ato të gjykuara nga Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është i treti i realizuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes. Në këtë kontekst, analiza për organet e posaçme për vitin 2022, bazohet në metodologjinë e hartuar në raportin e vlerësimit “Veprimtaria e Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitin 2020”,⁴³ e cila është ndjekur edhe për hartimin e raporteve të dy viteve të mëparshme 2020 dhe 2021.

Metodologjia bazohet në një numër indikatorësh të matshëm (shih tabelën 1) e hartuar për të kryer vlerësimin në përputhje me specifikat dhe problematikat e çështjeve të korrupsionit dhe krimin të organizuar të hetuara nga Prokuroria e Posaçme dhe të gjykuara nga Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (Shkalla e Parë dhe Apeli).

Metodologjia bazohet në matjen e tre dimensioneve kryesore të cilat përfshijnë: (1) produktivitetin, (2) efikasitetin dhe (3) relevancën, mbi bazën e të cilave është vlerësuar efektiviteti i përgjigjes ndaj fenomeneve të korrupsionit dhe krimin të organizuar në Shqipëri.

1. Dimensioani i produktivitetit është fokusuar në vlerësimin e numrit të rasteve të iniciuara në baza vjetore si dhe statusin e tyre aktual;
2. Dimensioani i efikasitetit është fokusuar në vlerësimin e kohëzgjatjes së çështjeve sipas kalendarit kohor të gjykatave dhe kohëzgjatjes mesatare të çështjes;
3. Dimensioani i relevancës është fokusuar në vlerësimin e çështjeve në përputhje me kompleksitetin dhe rëndësinë.

1.4 Mbledhja e të dhënave dhe kufizimet në zbatimin e metodologjisë

Mbledhja e të dhënave është realizuar nëpërmjet grumbullimit të informacionit dhe të dhënave të publikuara nga instucionet respektive: Prokuroria e Posaçme Kundër

⁴³ Dyrmishi, A, Hallunaj, M, Raport Vlerësimi “Veprimtaria e Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar 2020”. Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Shkurt 2021: Link-u i publikimit: http://csdgalbania.org/sq/ep-content/uploads/2021/03/Raport-Vleresimi_SPAK-Gjykatat-2020-FINAL-1.pdf

Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe Gjykatat e Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Gjithashtu, në këtë raport janë referuar edhe burime dytësore, në funksion të plotësimit të informacionit për të dhënat e referuara këtu.

Për sistemimin e të dhënave të marra nga institucionet zyrtare, përmes faqeve të tyre zyrtare, është krijuar një bazë të dhënash e detajuar me qëllim vlerësimin e mëtejshëm të ecurisë së çështjeve penale për korrupsionin dhe krimin e organizuar, të cilat janë analizuar bazuar në metoda analitike sasiore dhe cilësore.

Bazuar në këtë metodologji, hapat e ndjekur përfshijnë:

1. Mbledhjen e informacionit/të dhënave në lidhje me ecurinë e çështjeve;
2. Analizimin e të dhënave/çështjeve në përputhje me indikatorë e përcaktuar.

Gjatë hartimit të kësaj baze të dhënash janë marrë në konsideratë edhe mangësi të cilat lidhen me disponibilitetin e informacionit/të dhënave të publikuara apo përditësimin e tyre, megjithë minimizimin e këtyre mangësive duke ju referuar vetëm organeve zyrtare apo informacioneve të bëra publike nga përfaqësues të këtyre institucioneve në platforma të ndryshme mediatike.

Në këtë kuadër, duhet theksuar që në krye të herës se në faqen zyrtare të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në rubrikën këndi i informimit (çështje të përfunduara/dosje penale) vendimi i fundit i publikuar mban datën 27.07.2022, vendim për çështjen numër 100.⁴⁴ Që prej kësaj datë vendimet nuk janë publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate. Nga ana tjetër, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk ka bërë publike ndonjë raport vjetor të punës për vitin 2022. Duke marrë në konsideratë këta faktorë është bërë kryqëzimi i të dhënave duke përdorur raportet e publikuara në faqet zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) si dhe Vjetarin Statistikor të publikuar nga Ministria e Drejtësisë. Edhe këtu mungon vjetari për vitin 2022.

Duke qenë viti i tretë i publikimit të këtij raporti, analiza e bazuar në metodologjinë e mësipërme, ka patur në fokus gjithashtu edhe krahasimin me dy vitet e mëparshme si dhe të prodhojë gjetje dhe rekomandime mbi këtë bazë gjetjesh.

⁴⁴https://www.gjp.gov.al/Kendi_informativ/Ceshtje_te_perfunduara/Dosje_penale/#/?NrPage=1&recPages=100&ftdb=01.01.2022&ftde=31.12.2022

Lloji i veprave penale	Produktiviteti			Efiçenca					Relevanca	
	Numri i çështjeve			Kohëzgjatja e procesit gjyqësor					Statusi i subjekteve të akuzuar/dënuar	Niveli i pasojës që rezulton nga sjellja kriminale
Vepra penale të korrupsionit	Çështje të regjistruara	Çështje në proces	Çështje të përfunduara	< 1 muaj	1-6 muaj	7-12 muaj	1-2 vjet	> 2 vjet	Funksionarë të lartë shtetërorë ose të zgjedhur vendorë	Vlera ekonomike (humbja) më shumë se 1 milion Euro
									Gjyqtarë, prokurorë dhe funksionarë të tjerë të drejtësisë	Vlera ekonomike (humbja) ndërmjet 400 mijë Euro dhe 1 milion Euro.
									Persona që ushtrojnë funksione publike/Të tjerë	Vlera ekonomike (humbja) ndërmjet 100 deri 400 mijë Euro
Vepra penale në fushën e krimit të organizuar	Numri i çështjeve			Kohëzgjatja e procesit gjyqësor					Kompleksiteti i krimit	Niveli i pasojës që rezulton nga sjellja kriminale
	Çështje të regjistruara	Çështje në proces	Çështje të përfunduara	< 1 muaj	1-6 muaj	7-12 muaj	1-2 vjet	> 2 vjet	Veprat kryesore penale	Vlera e mallrave të ligjshëm dhe/ose të paligjshëm të përfshirë
									Numri i personave të përfshirë ⁴⁵	Veprimtaria/veprimet themelore kriminale të ndërmarra
									Zona gjeografike e veprimit (veprimtari transnacionale e krimit të organizuar) ⁴⁶	Mënyra e veprimit (modus operandi) të krimit të organizuar ⁴⁷

Tabela 1: Indikatorët e përdorur për të vlerësuar procedimet penale në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar

⁴⁵ Numri i anëtarëve të grupit më shumë 10, **i Lartë**; Numri i anëtarëve të grupit ndërmjet 5-10, **Mesatar**; Numri i anëtarëve të grupit ndërmjet 3-5, **i Ulët**.

⁴⁶ Aktivitet, i cili përfshin Shqipërinë dhe 1 vend tjetër; Aktivitet, i cili përfshin Shqipërinë dhe 2 vende të tjera; Aktivitet, i cili përfshin Shqipërinë dhe më shumë se 2 vende të tjera.

⁴⁷ Organizata kriminale është e përfshirë në më shumë se një vepër kriminale

II: Vlerësimi i përmbushjes së prioriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

2.1 Produktiviteti

Sikurse u nënvizua në seksionin e metodologjisë, dimensionin e produktivitetit fokusohet në vlerësimin e numrit të rasteve të procedimeve penale mbi baza vjetore dhe statusin e tyre aktual.

Kështu, në Prokurorinë e Posaçme për vitin 2022 janë hetuar gjithsej 712 procedime penale, nga të cilat 257 procedime penale janë rregjistruar si të reja për vitin 2022 dhe 455 procedime penale janë mbartur nga viti 2021.⁴⁸ Ngarkesa mesatare faktike për vitin 2022 rezulton të jetë 42 procedime penale.⁴⁹

Tabela 2 jep në mënyrë të përmbledhur numrin e procedimeve penale të hetuara nga Prokuroria e Posaçme përgjatë viteve 2020-2022. Sikurse vërehet, për vitin 2022, kemi në total 3 (tre) procedime penale më pak sesa viti 2021. Për më tepër, gjatë vitit 2022 vërehet se janë në total 106 procedime të reja më pak në raport me vitin 2021. Ndërkohë, numri i procedimeve të mbartura është rritur në mënyrë eksponenciale nga viti në vit. SPAK shprehet se “numri i konsideueshëm i procedimeve të mbartura ngelet problematik dhe ato duhet të trajtohen sipas prioriteteve të veprave penale me qëllim përfundimin e tyre në kohë.”⁵⁰

Procedime penale	2020 ⁵¹	2021	2022
Të reja	384	363	257
Të mbartura	204	352	455
Totali	588	715	712

Tabela 2: Numri i procedimeve penale të hetuara nga Prokuroria e Posaçme (2020-2022)

Burimi: Struktura e Posaçme Kundër korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Raporti vjetor 2020, Raporti vjetor 2021, Raporti vjetor 2022

⁴⁸ Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Raporti vjetor 2022, fq 18 <https://spak.gov.al/raporti-vjetor>

⁴⁹ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Raporti Vjetor 2022, fq. 53. <https://klp.al/wp-content/uploads/2023/05/Raporti-Vjetor-2022-2.docx>

⁵⁰ Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Raporti vjetor 2022, fq 6 <https://spak.gov.al/raporti-vjetor>

⁵¹ Për vitin 2020, në Prokurorinë e Posaçme 204 procedime penale kanë ardhur për kompetencë nga ish Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe 384 procedime janë rregjistruar nga Prokuroria e Posaçme.

Lidhur me numrin e personave nën hetim të dhënat paraqiten në tabelën 3. Për vitin 2022, për 643 procedime penale janë nën hetim 602 persona,⁵² 83 persona më shumë sesa në vitin 2021.

	2020	2021	2022
Numri total i procedimeve penale nën hetim ⁵³	564	675	643
Numri i personave nën hetim	746	519	602

Tabela 3: Numri i personave nën hetim nga Prokuroria e Posaçme (2020-2022)

Burimi: *Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Raporti vjetor 2020, Raporti vjetor 2021, Raporti vjetor 2022*

Në tabelën 4, përmbledhen treguesit e mënyrës së përfundimit të procedimeve penale. Sikurse vihet re, numri i procedimeve penale të dërguara për gjykim vijon të mbetet i ulët krahasur me numrin e procedimeve penale në hetim. Kështu, në total nga viti 2020-2022 janë rregjistruar 1882 procedime penale, nga të cilat vetëm 175 (9.3%) janë dërguar për gjykim. Nga ana tjetër, numri i procedimeve penale të mbartura nën hetim, vijon të mbetet i lartë. Në vitin 2022 janë vetëm 2 (dy) çështje më pak të mbartura në krahasim me vitin 2021.

	2020	2021	2022
Numri total i procedimeve penale në hetim	564	675	643
Numri i procedimeve të dërguara për gjykim	70	48	57
Numri i procedimeve mbartur nën hetim	348	449	447

Tabela 4: Treguesit e mënyrës së përfundimit të procedimeve penale (2020-2022)


Burimi: *Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Raporti vjetor 2020, Raporti vjetor 2021, Raporti vjetor 2022*

⁵² Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Raporti vjetor 2022, fq 18

<https://spak.gov.al/raporti-vjetor>

⁵³ Numri total i procedimeve penale, nxirret duke zbritur numrin e procedimeve penale për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal, numrin e çështjeve dërguar për kompetencë në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore dhe numrin e procedimeve penale për të cilat është vendosur bashkimi i çështjeve.

Të ndara sipas grupveprave penale dhe mënyrës së përfundimit të procedimeve penale të dhënat paraqiten në grafikun 1. Dukshëm, numrin më të lartë të procedimeve penale të regjistruara e përbëjnë ato të lidhura me korrupsionin. Sikurse u theksua edhe më sipër, numri i procedimeve të dërguara për gjykim mbetet i ulët. Kështu për vitin 2022 janë dërguar për gjykim 43 procedime penale për vepra penale që lidhen me korrupsionin (10 më shumë se viti 2021) dhe 10 procedime penale për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar (4 më pak se viti 2021).



Grafiku 1: Mënyra e përfundimit të procedimeve penale sipas grup-veprave penale (2020-2022)

Burimi: Struktura e Posaçme Kundër korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Raporti vjetor 2020, Raporti vjetor 2021, Raporti vjetor 2022

Ndërkohë, analiza vjetore e punës së Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk pasqyron ndonjë ndarje të qartë mbi numrin e rasteve të gjykuara sipas grupveprave penale korrupsion dhe krim i organizuar. Për më tepër, në faqen zyrtare të gjykatës në rubrikën Këndi informativ/Evidenca statistikore, ku siç shkruhet në faqe evidencat statistikore mund të kërkohen sipas kategorise dhe statusit të tyre në procesin e gjykimit,⁵⁴ nuk gjenden të dhëna të publikuara. Në këtë kontekst, përveç të dhënave të marra nga analiza vjetore e punës, është bërë edhe kryqëzimi i të dhënave me raportin vjetor të KLGJ-së. Gjithashtu, në faqe gjenden të publikuara vetëm analiza vjetore për vitin 2021,⁵⁵ dhe për vitin 2022⁵⁶, por jo për vitin 2020.

Kështu, në total për vitin 2022, janë rregjistruar 139 çështje pranë GJKKO, nga të cilat 78 çështje janë përfunduar me vendim, dhe 61 çështje janë mbartur për në 2023. Një vit më parë (në vitin 2021), u rregjistruan 149 çështje, nga të cilat 99 çështje u përfunduan me vendim dhe 50 çështje u mbartën për 2022. Sikurse vihet re, në vitin 2022 janë rregjistrua në total 10 çështje më pak se një vit më parë dhe janë dhënë 38 vendime më pak se gjatë vitit 2021.

Duhet theksuar se vepra penale me më shumë çështje të gjykuara për të dy vitet është ajo sipas neneve 120/1; 120/2 “Shpifja; Shpifja botërisht, në dëm të disa personave, ose më shumë se një herë” (shiko tabelën 5). Përkatësisht në vitin 2021, janë rregjistruar 24 çështje, janë dhënë 14 vendime dhe janë mbartur 10 të tjera. Edhe në vitin 2022, janë rregjistruar 24 çështje për veprën e mësipërme penale, janë dhënë 18 vendime dhe janë mbartur 16 çështje për vitin 2023.

Vepra e dytë e cila mbizotëron për të dy vitet është ajo sipas nenit 259 të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”. Kështu, për vitin 2021 janë rregjistruar 23 çështje, janë dhënë vendime për 19 çështje dhe janë mbartur 4 çështje. Ndërkohë, për vitin 2022 janë rregjistruar 13 çështje, janë dhënë vendime për 4 çështje dhe janë mbartur për vitin 2023 9 çështje. Sikurse vihet re, për vitin 2022 janë rregjistruar 10 çështje me pak lidhur me korrupsionin pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike dhe janë dhënë plot 15 vendime me pak.

⁵⁴ https://www.gjp.gov.al/Kendi_informativ/Evidencat_statistikore/

⁵⁵ Analiza vjetore e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar 2021. http://www.gjp.gov.al/rc/doc/Analiza_vjetore_2021_GJKKO_4774.pdf

⁵⁶ Analiza vjetore e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar 2022. http://www.gjp.gov.al/rc/doc/Analiza_Vjetore_e_punes_viti_2022_4814.pdf


Nenet/ Emërtimi i nenit	2021			2022		
	Çështje të regjistruara	Çështje të përfunduara me vendim	Çështje të mbartura në 2022	Çështje të regjistruara	Çështje të përfunduara me vendim	Çështje të mbartura në 2023
120/1; 120/2 Shpifja; Shpifja botërisht, në dëm të disa personave, ose më shumë se një herë	24	14	10	24	18	6
259 Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	23	19	4	13	4	9

Tabela 5: Veprat penale me më shumë çështje të gjykuara nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Ndërkohë, lidhur me veprën penale sipas nenit 244 të Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, për vitin 2021 janë rregjistruar 17 çështje, janë dhënë 16 vendime dhe është mbartur 1 çështje. Për vitin 2022 janë rregjistruar vetëm 4 çështje, pra 13 çështje më pak lidhur me veprën penale të korrupsionit aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike. Ndërkohë, është dhënë vendim vetëm për 1 çështje dhe janë mbartur 3 të tjera. Shtojca 1 paraqet të dhëna të detajuar mbi çështjet e rregjistruara, gjykuara dhe mbartura për të dy vitet sipas veprave penale.

Nga ana tjetër, në faqen e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk gjendet i publikuar një raport vjetor për vitin 2022. Për më tepër, në menunë “Statistika” nuk gjenerohen dot të dhëna për vitin 2022. Për këtë arsye, të dhënat për këtë gjykatë janë nxjerrë nga raporti vjetor i KLGJ-së.

Grafiku 2 përmbledh çështjet e mbartura (backlogun) në Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjatë 2020-2023 si dhe çështjet e reja të regjistruara sipas gurrveprave penale. Sikurse vihet re, numri më i lartë i çështjeve të regjistruara në gjykatë i përkasin çështjet penale administrative. Gjithashtu, vërehet “dyfishim i numrit të krimeve të regjistruara”⁵⁷ dhe numri shumë i vogël dhe i pandryshuar i çështjeve të ligjit antimafia. Në total gjatë vitit 2022, në këtë gjykatë janë regjistruar 314 çështje të reja, 53 më pak se viti 2021. Ndërkohë, vlen të theksohet se numri i çështjeve të mbartura (backlog-u) është përkatësisht 24 çështje në vitin 2020 dhe 2022 dhe 23 çështje në vitin 2021. KLGJ shprehet se “këto vlera tregojnë menaxhim shumë të mirë të ngarkesës gjyqësore dhe një mungesë stoku real, pasi çështjet e mbartura mund të jenë çështje në shqyrtim në kohën e raportimit”.⁵⁸



Grafiku 2: Backlog-u dhe çështjet e reja të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (2020-2022)

Burimi: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raport mbi ecurinë e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022

2.2 Efiçenca

Sikurse u nënvizua në seksionin e metodologjisë, dimensionin e efiçencës është fokusuar në vlerësimin e kohëzgjatjes së çështjeve sipas kalendarit kohor të gjykatave dhe kohëzgjatjes mesatare të çështjes.

⁵⁷ Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raport mbi ecurinë e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022, fq. 62. <https://klgj.al/2023/07/raporti-vjetor-klgj-2021-2/>

⁵⁸ Po aty, fq. 62.

2.2.1 E drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm

E drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm është thelbësore për garantimin e një procesi të rregullt ligjor.⁵⁹ Ky parim siguron administrimin efektiv të sistemit gjyqësor, rritjen e efektivitetit të trajtimit të çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe ndikon në rritjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Neni 42, pika 2, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë thotë se kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Kjo e drejtë mbrohet edhe nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ-ja) dhe neni 14 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP-ja).⁶⁰

Gjykata Kushtetuese, referuar në standardet e GJEDNJ-së, ka përcaktuar këto kritere, të cilat merren parasysh për të vlerësuar afatin e arsyeshëm: (i) *Kompleksiteti i çështjes ligjore*; (ii) *Sjellja e kërkuarit*; (iii) *Sjelljen e autoriteteve shtetërore*; dhe (iv) *Rrezikun që sjell për kërkuarin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit*.⁶¹ Për çështjet penale, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë parashikon se gjykatat duhet të përfundojnë shqyrtimin gjyqësor në një seancë të vetme dhe nëse kjo nuk është e mundur, atëherë gjykata vendos që të vazhdojë ditën e mëpasshme të punës dhe vetëm për arsye të veçanta shqyrtimi gjyqësor mund të shtyhet deri në pesëmbëdhjetë ditë. Kjo është në përputhje me parimin e “gjykimit të pandërprerë”, i cili ka si qëllim prezantimin e plotë dhe koherent të fakteve përpara trupit gjykues të çështjes, duke lehtësuar kështu vlerësimin nga ana e trupit gjykues të materialeve të paraqitura përpara tij.⁶²

Ndërkohë, sipas raportit të Komisionit Evropian, Shqipëria për vitin 2021 kishte, 307 gjyqtarë me kohë të plotë (10,8 për 100,000 banorë) dhe 300 prokurorë me kohë të plotë (10,5 për 100,000 banorë). Sipas Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), mesataret evropiane është 21 gjyqtarë dhe 12 prokurorë për 100 000 banorë.⁶³ Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve për frymë në vend, dukshëm më i ulët se mesatarja evropiane, ndikon në kohën dhe cilësinë e përfundimit të proceseve gjyqësore. Kjo rezulton në (i) mbartjen e çështjeve (backlog), (ii) rritjen e ngarkesës së punës për prokurorët dhe gjyqtarët, (iii) cilësinë e vendimeve gjyqësore, (iv) rënie të efikasitetit të të gjithë sistemit gjyqësor dhe (v) rënie të besimit të publikut.

⁵⁹ Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, 2015, fq. 86

https://www.reformanedrejtisi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf

⁶⁰ Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, 2015, fq. 86.

https://www.reformanedrejtisi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf

⁶¹ Po aty, fq. 86.

⁶² Po aty, fq. 87.

⁶³ Komisioni Evropian, (2022), Progres Raporti për Shqipërinë 2022, fq. 22.

Kjo është veçanërisht e dukshme në rastin e strukturave të posaçme, të cilat si struktura të ngritura rishtazi vuajnë mungesën e burimeve njerëzore. Në këtë kontekst, rekrutimi dhe forcimi i kapaciteteve, përfshirë rekrutimin me prioritet të stafit teknik dhe burimeve të nevojshme njerëzore të specializuara dhe mirëtrajnuara kanë qenë disa nga rekomandimet e GRECO-s.⁶⁴

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar edhe rekomandimit të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, ka vijuar të plotësojë vendet vakante të strukturave të posaçme. Kështu, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitin 2022 ka funksionuar me vetëm 7.91 gjyqtarë efektivë nga 11 gjyqtarë sipas dekretit ose rreth 72% të organikës së parashikuar.⁶⁵ Përsa i përket administratës gjyqësore, ajo ka pasur në dispozicion 22.92 staf efektiv, nga 31 të prashikuar në organikë ose rreth 74% të stafit të parashikuar.⁶⁶ Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka funksionuar me 7.5 gjyqtarë efektivë nga 16 sipas dekretit, ose me 47% të organikës së parashikuar, dhe me 45.5 staf mbështetës nga 49 sipas organikës, ose me 93%.⁶⁷

Ndërkohë, SPAK operon me 17 prokurorë nga 20 të miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), si dhe ka plotësuar organikën prej 60 hetuesish të BKH-së.⁶⁸ Mund të thuhet se nga pikëpamja organizative, struktura e SPAK ka ardhur drejt konsolidimit, sidoqoftë organika nuk është e plotë dhe plotësimi me prokurorë dhe staf mbetet ende në proces.

2.2.2 Kohëzgjatja e çështjeve për korrupsionin dhe krimin e organizuar

Sikurse është theksuar edhe më sipër, në faqen zyrtare të GJKKO, nuk mund të gjenerohet asnjë informacion në menunë “kohëzgjatja e çështjes”, e evidentuar kjo edhe në raportin e vitit 2022 të gjykatës.⁶⁹ Ndërkohë, është e mundur nxjerrja e disa të dhënave në raportin e sipërpërmendur, por këto janë të kategorizuara si çështje penale themeli, duke mos bërë një ndarje të kohëzgjatjes për çështjet e korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Referuar raportit, 72% e çështjeve (N=56) kanë zgjatur 0-6 muaj, 22% (N=17) kanë zgjatur 6-12 muaj dhe 6% (N=5) kanë zgjatur mbi 1 vit. Ndërkohë, rezulton se 67% e

⁶⁴ GRECO, Fifth Evaluation Round “Preventing corruption and promoting integrity in central governments (top executive functions) and law enforcement agencies”, fq. 52: <https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventingcorruption-and-promoting-integrity-i/1680a0923d>

⁶⁵ Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raport mbi ecurinë e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022, fq. 61. <https://klgj.al/2023/07/raporti-vjetor-klgj-2021-2/>

⁶⁶ Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raport mbi ecurinë e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022, fq. 63. <https://klgj.al/2023/07/raporti-vjetor-klgj-2021-2/>

⁶⁷ Po aty, fq. 65.

⁶⁸ Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Raporti vjetor 2022, fq. 6 <https://spak.gov.al/raporti-vjetor>

⁶⁹ Analiza vjetore e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar 2022, fq. 41.

stokut të çështjeve përbëhet nga çështjet e reja të regjistruara gjatë 2022 nga të cilat, 31% janë çështje të regjistruara në 6 mujorin e dytë të vitit; 51 çështje ose 34% e stokut janë në pritje të gjykimit prej më shumë se një vit, dhe vetëm 1 çështje pret prej më shumë se 3 vitesh.⁷⁰

Për vitin 2021, rezulton se 84% e stokut të çështjeve përbëhet nga çështjet e reja të regjistruara gjatë 2022 nga të cilat, 50% janë çështje të regjistruara në 6 mujorin e dytë të vitit; 62 çështje, ose 34% e backlog-ut janë në pritje të gjykimit prej më shumë se një vit, dhe vetëm 1 çështje pret prej më shumë se 2 vjetësh.⁷¹

2.2.3 Track records dhe sistemi i integruar për menaxhimin e çështjeve

Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor janë organet kryesore për menaxhimin e sistemit të prokurorisë dhe atij gjyqësor,⁷² duke luajtur edhe një rol të rëndësishëm në monitorimin e veprimtarisë së Prokurorisë dhe Gjykatave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të organizuar, të cilat raportojnë mbi veprimtarinë e tyre.

Vendi ka bërë përpunim në mbledhjen e të dhënave statistikore të sistemit gjyqësor dhe raportimin e tyre.⁷³ Kështu, pranë zyrës së Regjistrimit në SPAK, është ndërtuar një regjistër të dhënash lidhur me procedimet penale, nga rregjistrimi i tyre fillestar deri në dërgimin e tyre në gjykatë, çfarë shërben si një “track record” dhe tregues i punës së prokurorëve në ndjekjen e çështjeve penale.⁷⁴ Gjithashtu, GJKKO raporton në mënyrë periodike, çdo 6 muaj pranë Ministrisë së Jashtme, Track-Record-et në lidhje me çështjet e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nëpërmjet të cilave shpjegohet ecuria e këtyre çështjeve në çdo fazë të gjykimit.⁷⁵

Megjithë këto, përpjekje të mëtjeshme janë të domosdoshme, me qëllim krijimin e një sistemi të ri të menaxhimit të integruar të të dhënave dhe për të siguruar ndërveprimin e tij në të gjithë sistemin e drejtësisë në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).⁷⁶ Ndër të tjera, sistemi i integruar i

⁷⁰ Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raport mbi ecurinë e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022, fq. 67. <https://klgj.al/2023/07/raporti-vjetor-klgj-2021-2/>

⁷¹ Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raport mbi ecurinë e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2021, fq. 51. <https://klgj.al/2022/04/raporti-vjetor-klgj-2021/>

⁷² Ligji 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

⁷³ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2021, fq. 22. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

⁷⁴ Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Raporti vjetor 2022, fq 6 <https://spak.gov.al/raporti-vjetor>

⁷⁵ Analiza vjetore e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar 2022, fq. 47.

⁷⁶ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2021, fq. 22. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

menaxhimit të çështjeve do të rriste efikasitetin dhe transparencën e sistemit. Kjo theksohet edhe në raportin e Komisionit Evropian, ku ndër të tjera thuhet se “në ngritja e një sistemi modern të integruar të menaxhimit të çështjeve do të përmirësonte efikasitetin dhe transparencën e sistemit gjyqësor.”⁷⁷ Ky është një rekomandim i përsëritur edhe në raportin e vitit 2022.⁷⁸

Për më tepër, raporti i Komisionit Evropian për vitin 2022, thekson nevojën për krijimin e një historiku hetimesh, ndjekjesh penale dhe gjyqësorit të çështjeve të korrupsionit, sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve, që vijnë nga vepra që lidhen me korrupsionin.⁷⁹

Gjithashtu, kërkohet përmirësimi i track records mbi hetimin, ndjekjen penale, gjyqimin, dhe konfiskimin e aseteve, burime të krimit të organizuar dhe pastrimit të parave, veçanërisht të niveleve të larta.⁸⁰

Rekomandimet e tjera të Komisionit Evropian në lidhje me nivelin e përgatitjes dhe përparimit të vendit në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar i gjeni në shtojcën 3.

2.3 Relevanca

Sikurse është theksuar më sipër në këtë raport, analiza bazohet në të dhënat e publikuara në faqet zyrtare të Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatave. Për vitin 2022 në faqen zyrtare të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në rubrikën “Këndi i informimit” (çështje të përfunduara/dosje penale), vendimi i fundit i publikuar mban datën 27.07.2022, vendim për çështjen numër 100.⁸¹ Më tej nuk ka vendime të publikuara në faqen zyrtare të kësaj gjykate. Për më tepër, sikurse vihet në dukje edhe në raportin vjetor të kësaj gjykate, sistemi i informimit dhe publikimit të të dhënave për publikun në menunë e informacioneve të tjera, të tipit “detaje të çështjes”, “çështje në gjykim”, “kohëzgjatja e çështjes”, “informacion mbi seancën”, janë totalisht jashtë pune.⁸²

⁷⁷Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2022, fq. 20. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

⁷⁸Po aty, fq. 20.

⁷⁹Po aty, fq. 23.

⁸⁰Komisioni Evropian, (2023), Shqipëria Screening 2023, fq 79. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en

⁸¹https://www.gjp.gov.al/Kendi_informativ/Ceshtje_te_perfunduara/Dosje_penale/#/?NrPage=1&recPages=100&ftdb=01.01.2022&ftde=31.12.2022


⁸²Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, (2023), Analiza vjetore e punës 2022, fq. 41.

Ndërkohë, në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar mund të gjenerohen disa të dhëna në rubrikën “Statistika”⁸³ si dhe në rubrikën “Çështjet penale”⁸⁴ Nga ana tjetër, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk ka publikuar një analizë vjetore të punës për vitin 2022.

Në këtë kontekst, ky seksion i cili vlerëson relevancën, thënë ndryshe çështjet e trajtuara nga institucionet e posaçme në raport me kompleksitetin dhe rëndësinë dhe që do të duhej të bazohej kryesisht në analizën e vendimeve të gjykatave,⁸⁵ falë rrethanave të shpjeguara më sipër, do të kufizohet vetëm në të dhënat e publikuara në raportin vjetor të SPAK, GJKKO-së dhe aq të dhëna se mund të aksesohen nga publiku i gjerë në faqen zyrtare të strukturave të posaçme.

2.3.1 Procedimet penale dhe ndëshkimet për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë

Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit të Transparencës Ndërkombëtare për vitin 2022, e renditi Shqipërinë në vendin e 101-të ndër 180 vende.⁸⁶ Pavarësisht rritjes me një pikë në krahasim me vitin 2021, vendi ende renditet në mesin e vendeve me korrupsionin më të lartë në Evropë.



Grafiku 3: Indeksi i perceptimit të korrupsionit

⁸³ <https://www.gjykata.gov.al/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/statistika/c%3%ABshtjet-penale/>


⁸⁴ <https://www.gjykata.gov.al/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/c%3%ABshtjet-gjyq%3%ABsore/c%3%ABshtjet-penale/>

⁸⁵ Smejkalová, Terezie (2020), Importance of judicial decisions as perceived level of relevance, Utrecht Law Review.

⁸⁶ Transparenca Ndërkombëtare, Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2022. <https://www.transparency.org/en/cpi/2022/index/alb>

Ky nivel i lartë i korrupsionit pasqyrohet edhe nga anketat publike. Në vitin 2022, shumica e shqiptarëve të anketuar (76.5%) e konsideruan korrupsionin e vogël (e nivelit të ulët) si të përhapur ose shumë të përhapur, krahasuar me 79.1% që kanë këtë mendim për korrupsionin e madh (e nivelit të lartë).⁸⁷ Ndërkohë, 65.8% e shqiptarëve nuk kanë besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të madh, ndërsa 56.9% nuk kanë besim në ndëshkimin efektiv të korrupsionit të vogël.⁸⁸ Në të njëjtën linjë është edhe raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022, i cili thekson se korrupsioni është i përhapur në shumë fusha të jetës publike dhe të biznesit duke mbetur një shqetësim serioz për vendin.⁸⁹

Sipas të dhënave të publikuar nga Prokuroria e Posaçme,⁹⁰ për vitin 2022, kjo strukturë ka dërguar për gjykim 43 çështje penale për vepra të lidhura me korrupsionin (shih grafikun 4) me 208 të pandehur të akuzuar (shih grafikun 5).



Grafiku 4: Numri i çështjeve të dërguara për gjykim nga SPAK (2020-2022)


Burimi: Struktura e Posaçme Kundër korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Raporti vjetor 2020, Raporti vjetor 2021, Raporti vjetor 2022

⁸⁷ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Sondazhi i opinionit publik 2022: Besimi në qeverisje, Edicioni i 10-të <https://idmalbania.org/publication-of-the-10th-edition-of-trust-in-governance-annual-public-opinion-poll-in-albania/>

⁸⁸ Po aty, fq. 6.

⁸⁹ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2022. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

⁹⁰ Raporti vjetor 2020, Raporti vjetor 2021, Raporti vjetor 2022. <https://spak.gov.al/raporti-vjetor>



Grafiku 5: Numri i të pandehurve (2020-2022)

Burimi: Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Raporti vjetor 2020, Raporti vjetor 2021, Raporti vjetor 2022

Për veprat penale që lidhen me korrupsionin ka një rritje me 30% të numrit të çështjeve dhe me 117% të të pandehurve në krahasim me vitin 2021.⁹¹ Ndërkohë, për vepra penale që lidhen me korrupsionin, gjatë vitit 2022, janë paraqitur 30 kërkesa për pushimin e çështjes me 15 persona nën hetim,⁹² janë pezulluar hetimet për 5 vepra penale⁹³ si dhe janë transferuar në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore 59 procedime penale me 42 persona nën hetim.⁹⁴

Në shtojcën 2 jepen të dhëna të detajuara lidhur me numrin e procedimeve penale për çështje të lidhura me korrupsionin dhe zgjidhjen e tyre nga viti 2020 deri në vitin 2022. Sikurse mund të vihet re, veprat penale të shpërdorimit të detyrës, korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike, korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë, përbëjnë numrin më të madh të procedimeve të filluara nga SPAK për vepra penale të lidhura me korrupsionin. Për vitin 2022, vërehet

⁹¹ Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Raporti vjetor 2022, fq 19 <https://spak.gov.al/raporti-vjetor>

⁹² Po aty, fq 12.

⁹³ Po aty, fq 12.

⁹⁴ Po aty, fq 12.

një rritje e procedimeve për vepra penale lidhur me shkeljen e barazisë së pjesëmarrësve në tendera dhe ankande publike.⁹⁵

Kështu, gjatë vitit 2021, janë dërguar për gjykim 7 çështje sipas nenit 248 “Shpërdorimi i detyrës” dhe ishin ende në hetim 77 të tjera. Për vitin 2022 ishin në hetim 60 çështje lidhur me shpërdorimin e detyrës, pra 17 çështje më pak. Ndërkohë, lidhur me çështjen sipas nenit 259 “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në total janë regjistruar 98 çështje për vitin 2020, 83 për vitin 2021 dhe 78 për vitin 2022. Sikurse vihet re kemi një rënie prej 20 çështjesh nga viti 2020 në vitin 2022. Gjithashtu për vitin 2022, janë rregjistruar në total 92 çështje sipas nenit 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, nga të cilat 6 janë dërguar për gjykim dhe 70 janë në hetim.

Gjithashtu, lidhur me veprën penale sipas nentit 319/ç “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” ka një rënie me 23 çështje nga viti 2020 në vitin 2022. Kështu në vitin 2020 në total u rregjistruan 67 çështje dhe në vitin 2022 44 çështje të lidhura me nenin 319/ç të Kodit Penal.

Ndërkohë, nga çështjet e dërguara për gjykim, në periudhën 2020- 2022 rezulton se në total Prokuroria e Posaçme ka dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim, ndaj ish-zyrtarëve të nivelit të lartë në total **vetëm 18 procedime penale me vetëm 19 të pandehur** si më poshtë:

- 8 procedime penale me 8 të pandehur (ish-Gjyqtar)
- 3 procedime penale me 3 të pandehur (ish-Prokuror)
- 1 procedim penal me 2 të pandehur (ish-Deputet)
- 1 procedim penal me 1 të pandehur (ish-zv.Ministër)
- 1 procedim penal me 1 të pandehur (anëtare KPK)
- 4 procedime penale me 4 të pandehur (ish-Kryetar Bashkie)⁹⁶

Sikurse e thekson edhe rrjeti investigativ BIRN: “Prokuroria e Posaçme vijon prej vitesh hetime pa rezultate konkrete, për çështje të korrupsionit të zyrtarëve të lartë shtetërorë ku ngrihen dyshime për abuzime me qindra miliona euro nga fondet publike.”⁹⁷

⁹⁵ Përkatësisht, lidhur me vepër penale të “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera dhe ankande publike” janë përcjellë për gjykim 6 çështje, ndërkohë 70 çështje të tjera janë ende nën hetim. Për më tepër shiko: Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Raporti vjetor 2022, fq 63 <https://spak.gov.al/raporti-vjetor>

⁹⁶ Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Raporti vjetor 2022, fq 8. <https://spak.gov.al/raporti-vjetor>

⁹⁷ Hoxhaj, Edmond (2023), SPAK shënon rekorde në zvarritjen e hetimeve të korrupsionit në nivel të lartë, BIRN <https://www.reporter.al/2023/03/06/spak-shenon-rekorde-ne-zvarritjen-e-hetimeve-te-korrupsionit-ne-nivel-te-larte/>

Nga ana tjetër, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjatë vitit 2022, ka dhënë **vetëm 4 vendime dënimi** me 4 persona të dënuar për ish-zyrtarë të nivelit të lartë⁹⁸, dhe riktheu në SPAK hetimin pasuror për 7 ish-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese.⁹⁹ Diskrepancën mes numrit të çështjeve të hetuara dhe numrit të dënimeve e vë në dukje edhe Raporti i Komisionit Evropian “Shqipëria Screening 2023”.¹⁰⁰

Kështu, për vitin 2022, GJKKO ka dhënë dy vendime fajësie sipas nenit 319/ç “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe 2 vendime fajësie sipas nenit 319 “Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”.¹⁰¹ Gjithashtu, gjykata ka dhënë 9 vendime fajësie sipas nenit 245/1/2 “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, 9 vendime fajësie sipas nenit 248 “Shpërdorimi i detyrës”, 3 vendime fajësie sipas nenit 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, 3 vendime fajësie sipas nenit 259 “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”.¹⁰²

Vlen të theksohet kjo gjykatë ka mbartur për vitin 2023, ndër të tjera,

- 9 çështje sipas nenit 259 “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”,
- 3 çështje sipas nenit 244 “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”,
- 5 çështje sipas nenit 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”.¹⁰³

Pavarësisht mospërputhjes së madhe mes rasteve të hetuara dhe dënimeve, vendimet kanë dhënë rezultat në vlerësimin e perpjekjeve të vendit në luftën kundër korrupsioni. Referuar raportit të Freedom House “Kombe në Tranzicion”, “vlerësimi për luftën kundër korrupsionit u rrit nga 2.75 në 3.00 falë një sërë aktakuzash dhe dënimesh të profilit të lartë të ish-zyrtarëve nga Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), si dhe rolit të saj proaktiv në nxitje e luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar”.¹⁰⁴

⁹⁸ Po aty, fq. 9.

⁹⁹ Hoxhaj, Edmond (2022), “Hetime të paplota”: Gjykata rikthen në SPAK hetimin pasuror për 7 ish-gjyqtarë, BIRN: <https://www.reporter.al/2022/07/07/hetime-te-paplota-gjykata-rikthen-ne-spak-hetimin-pasuror-per-7-ish-gjyqtare/>

¹⁰⁰ Komisioni Evropian, (2023), Shqipëria Screening 2023, fq 51. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en

¹⁰¹ Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, (2023), Analiza vjetore e punës 2022, fq. 57.

¹⁰² Po aty, fq. 59-60.

¹⁰³ Po aty, fq. 57-58.

¹⁰⁴ <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2023>

2.3.2 Sekuestrimi dhe konfiskim i aseteve kriminale që rezultojnë nga vepra të lidhura me korrupsionin

Raporti i Komisionit Evropian “Shqipëria Screening 2023” thekson nevojën për implementimin e ligjit anti-mafia për sekuestrimin dhe konfiskimin parandalues, me qëllim ngrirjen e aseteve kriminale dhe ripërdorimin e tyre social.¹⁰⁵ Edhe Progres Raporti 2022 ndonëse thekson se është arritur një progres i mirë në sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të lidhura me korrupsionin rekomandon progres të mëtejshëm në vendosjen e track-records lidhur me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit dhe sekuestrimin/konfiskimin e aseteve që burojnë nga korrupsioni dhe krimi i organizuar.¹⁰⁶

Gjatë vitit 2021, u sekuestruan pasuri që buronin nga korrupsioni me vlerë 21.5 milion EUR¹⁰⁷. Në gjysmën e parë të 2022, u sekuestruan asete me vlerë 37 milion dhe vetëm pak prej tyre u konfiskuan.¹⁰⁸

Gjatë raportimit në Komisionin e Ligjeve në Kuvend, drejtuesi i SPAK theksoi se “Për vlerën e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara kemi tregues shumë pozitivë. Vlera mund të jetë të paktën me përafërsi mbi 100 milionë Euro. Ajo që më bën të ndihem më mirë është diversifikimi i llojeve të pasurive që sekuestrohen, llogari bankare, cash, pasuri të paluajtshme, biznese, në turizëm etj. Kjo shumë është më e lartë se 100 milionë Euro”.¹⁰⁹

Ndërkohë, Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK) nuk ka publikuar në faqen zyrtare të institucionit raportin e aktivitetit për vitin 2022, sikurse e ka bërë për vitin 2021. Për më tepër, tabela integrale e pasurive të sekuestruara, të revokuara dhe të konfiskuara nuk është përditësuar në vazhdimësi për të reflektuar edhe të dhënat e viteve 2021 dhe 2022.

Në mungesë të të dhënave të qarta dhe të përditësuar, edhe analiza më e thellë e performancës për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të lidhura me korrupsionin dhe krimin e organizuar bëhet e pamundur.

¹⁰⁵ Komisioni Evropian, (2023), Shqipëria Screening 2023, fq 74. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en

¹⁰⁶ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2022: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

¹⁰⁷ Po aty, fq. 24.

¹⁰⁸ Po aty.

¹⁰⁹ Mbi 100 milionë euro pasuri të sekuestruara nga SPAK: <https://tvklan.al/mbi-100-milione-euro-pasuri-te-sekuestruara-nga-spak/>

III: Transparenca

Sipas matjeve të opinionit publik, 25,9% e qytetarëve të anketuar në vitin 2022 pohojnë se gjykatat anti-korrupsion janë të përkushtuara në luftën kundër korrupsionit dhe një përqindje më e lartë prej 38,4% mendojnë se SPAK është serioz në luftën kundër korrupsionit.¹¹⁰ Të pyetur më tej për kontributin absolut të SPAK-ut në luftën kundër korrupsionit, rezultatet tregojnë se shumica e të anketuarve, përkatësisht 69,5% e tyre mendojnë se kontributi i SPAK-ut është shumë i rëndësishëm ose i rëndësishëm dhe vetëm 8% se është i parëndësishëm ose shumë i parëndësishëm.¹¹¹

Nga ana tjetër, besimi i publikut në përgjithësi mbetet i ulët. Pas partive politike dhe parlamentit, prokuroria (35.2%) dhe gjykatat (36.2%) janë institucionet më pak të besuara për vitin 2022.¹¹² Ndonëse besimi i publikut në gjykata është rritur me tetë pikë përqindje krahasuar me vitin 2021 (28%), sërisht ato renditen si institucionet më pak të besuara.¹¹³ Ndërkohë, SPAK, i ka një shkallë më të lartë besimi tek qytetarët (50%), krahasuar me nivelet e besimit të raportuara për prokurorinë (35.2%) dhe gjykatat (36.2%).¹¹⁴

Mungesa e besimit të publikut në institucionet e drejtësisë theksohet edhe në raportin e Freedom House “Liria në botë 2022”, ku nënvizohet se “besimi i publikut në institucionet gjyqësore është i ulët. Korrupsioni në gjyqësor mbetet një problem serioz dhe dënimet e gjyqtarëve të rangut të lartë për korrupsion dhe abuzim me pushtetin janë historikisht të rralla.”¹¹⁵

Përpos dënimit të gjyqtarëve për korrupsion dhe abuzim me pushtetin, një mënyrë për të rritur besimin e publikut ndaj sistemit të drejtësisë është transparenca. Sipas doktrinës, “një akses i gjerë në vendimet e gjyqësorit i jep mundësi publikut që të monitorojë nga afër punën e gjyqësorit, duke forcuar ndërkohë transparencën dhe përgjegjshmërinë e gjyqësorit.”¹¹⁶

¹¹⁰ Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Barometri i sigurisë Shqipëri, Anketë Kombëtare 2022, fq. 55. <https://csdgalbania.org/albanian-security-barometer-2022/>

¹¹¹ Po aty, fq. 61-62.

¹¹² Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, (2023) Sondazhi i opinionit publik 2022, Edicioni i 10^{-të}, fq.4. <https://idmalbania.org/sq/publikimi-i-edicionit-te-10-te-te-besimi-ne-qeverisje-sondazh-vjetor-i-opinionit-publik-ne-shqiperi/>

¹¹³ Po aty.

¹¹⁴ Po aty.

¹¹⁵ <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2022>

¹¹⁶ Faafeng, Jo et, al, (2013), Drejt drejtësisë, Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore, OSCE, fq. 80.

Sikurse e thekson edhe Rrjeti Evropian i Këshillave për Gjyqësorin (ENCJ 2018), “një sistem i hapur dhe transparent i drejtësisë është një parakusht i mëtejshëm për krijimin dhe ruajtjen e besimit të publikut në drejtësi, i cili është një gur themeli i legjitimitetit të gjyqësorit”.¹¹⁷ Për më tepër, “aksesi në informacion e gjykatat dhe administratat e gjykatave është i domosdoshëm për të parandaluar praktikat korruptive dhe për të garantuar realizimin e të drejtës për gjykim të drejtë duke i mbrojtur palët ndërgjyqëse nga administrimi i drejtësisë në mënyrë të fshehtë pa mbikëqyrjen e publikut”.¹¹⁸

Rezultatet e matjeve të opinionit të qytetarëve në lidhje me korrupsionin dhe sistemin gjyqësor në Shqipëri nxjerrin në pah një mospërthutje të rëndësishme. Nga njëra anë, nivelet e perceptuara të korrupsionit janë të larta por në të njëjtën kohë, strukturat e reja të drejtësisë, veçanërisht SPAK, vlerësohen pozitivisht nga një pjesë e madhe e qytetarëve për kontributin e tyre në luftën kundër korrupsionit. Nga ana tjetër, vetë institucionet e drejtësisë nuk janë plotësisht transparente në veprimtarinë e tyre për të adresuar në këtë mënyrë shqetësimin lidhur me perceptimin e korrupsionit si dhe për të thelluar besimin e qytetarëve në institucionet gjyqësore.

Një tipar thelbësor i një sistemi gjyqësor funksional është besimi i publikut te drejtësia dhe cilësia e drejtësisë së administruar nga sistemi. Thënë ndryshe, në mënyrë që një gjykatë të jetë efektive në dhënien e drejtësisë, publiku duhet të ketë besim në aftësinë e gjykatës për ta bërë këtë.¹¹⁹ Për më tepër, duke qenë se perceptimi i publikut është thelbësor për funksionimin efektiv të sistemit gjyqësor, është shumë e rëndësishme të merren në konsideratë opinionet e tyre mbi gjykatat.¹²⁰

Në këtë seksion analizohet rëndësia dhe roli që luan transparencja e institucioneve të drejtësisë në forcimin e besimit të publikut si dhe rritjen e llogaridhënies së sistemit gjyqësor¹²¹. Më poshtë raporti argumenton se transparencja u jep mundësi qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile të monitorojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë punën e sistemit gjyqësor. Për më tepër, transparencja e gjyqësorit ndihmon në rritjen e besimit

¹¹⁷ France, Guilherme. (2019), Transparenca e procedurave gjyqësore, Transparenca Ndërkombëtare, fq.3 <https://knowledgehub.transparency.org/helpdesk/transparency-of-court-proceedings>

¹¹⁸ Faafeng, Jo et, al, (2013), Drejt drejtësisë, Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore, OSCE, Fq.77.

¹¹⁹ United Nations Office on Drugs and Crime, (2011) Resource Guide on Strengthening Judicial Integrity and Capacity, fq. 97.

¹²⁰ Po aty.

¹²¹ Në një monitorim të realizuar në vitin 2018, bazuar në legjislacionin në fuqi, BIRN identifikoi 36 indikatorë të nivelit të përgjithshëm të transparencës të ndarë në gjashtë kategori kryesore: 1. Aksesin në gjykata; 2. Çështjet dhe vendimet gjyqësore; 3. Informacioni për publikun; 4. Organizimi i brendshëm; 5. Transparenca financiare; 6. E drejta e informimit. (Balkan Investigative Reporting Network, (2018), Monitorimi i nivelit të transparencës së gjykatave në Shqipëri, Tiranë, fq. 8-11). Ndërkohë, duke marrë parasysh metodologjinë e këtij raporti, fokusi është vetëm tek publikimi i vendimeve gjyqësore dhe aksesin i lirë i publikut në to.

të publikut në institucionet e drejtësisë dhe ndihmon në luftën kundër korrupsionit në tërësi, duke krijuar një mekanizëm efikas të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë.

3.1 Kuadri ligjor ku mbështetet disponueshmëria e vendimeve gjyqësore për publikun

Transparenca e gjyqësorit është një parim themelor që bazohet në një sërë normash të së drejtës ndërkombëtare si dhe në kuadrin ligjor vendas. Transparenca bazohet në dy parime thelbësore në të drejtën për informim dhe në të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor. Në kontekstin ndërkombëtar, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNj), apo Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP) vendosin standardet për zbatimin e transparencës në administrimin e drejtësisë. Ndërkohë, Kushtetuta dhe Ligji për të drejtën e informimit, përcakton detyrimet dhe kërkesat specifike për sigurimin e transparencës në sistemin gjyqësor. Kjo bazë ligjore ndihmon në sigurimin e përputhjes me parimet dhe vlerat themelore të drejtësisë, duke lejuar aksesin e publikut në procesin gjyqësor dhe përmirësimin e mbikëqyrjes së tij. Në kutizën më poshtë pasqyrohen një sërë normash të së drejtës ndërkombëtare tek të cilat mbështetet disponueshmëria e vendimeve gjyqësore.¹²²

Neni 10 i DUDNj-së

“Gjithkush gëzon një lloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale”

Neni 14 paragrafi 1 i PNDCP-së

“[...] Në përcaktimin e çfarëdo lloj akuze penale ndaj tij, apo të të drejtave dhe detyrimeve të tij në një çështje në gjykim, kushdo duhet të ketë të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe të hapur [...]”

Neni 6 paragrafi 1 i GjEDNj-së

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile apo të dënimit penal ndaj një njeriu, secili ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe të hapur[...] Vendimi duhet të shpallet publikisht [...]”

Neni 47 paragrafi 2 Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian

“Çdo njeri ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e ngritur më parë me ligj [...]”

¹²² Marrë nga: Faafeng, Jo et, al, (2013), Drejt drejtësisë, Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore, OSCE, Fq.78.

Nga ana tjetër, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 146, pika 2, sanksionon se “vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast.” Kushtetuta ka parashikuar rezervën absolute sipas së cilës, edhe nëse shqyrtimi gjyqësor, apo seanca, apo pjesë të saj, janë zhvilluar me dyer të mbyllura, vendimi përkatës i gjykatës, përherë duhet të shpallet publikisht.¹²³ Kriteri i shpalljes publike të vendimeve konsiderohet i përmbushur kur teksti i plotë i vendimit, i depozituar në sekretarinë e gjykatës, është i disponueshëm për këdo (vendimi nr. 26, datë 13.06.2011, i Gjykatës Kushtetuese).¹²⁴

Gjithashtu, transparenca garantohet edhe përmes Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në nenin 2, pika 1 të të cilit përcaktohet se “autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krujuara me Kushtetutë ose me ligj”. Ndërkohë, në pikën 2 përcaktohet se “informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.

Gjithashtu, Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 46 “Marrëdhëniet me publikun”, pika 1/d, parashikon se shërbimet për marrëdhëniet me publikun kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim që të publikohen të gjitha vendimet gjyqësore në përputhje me ligjin.

Për më tepër, Kodi Procedurës Penal përcakton në nenin 382 të tij procedurat dhe afatet që lidhen me përpilimin e vendimit gjyqësor. Sipas këtij neni pas marrjes së vendimit bëhet arsyetimi i tij duke u bazuar në provat dhe ligjin penal, si dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues. Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (pika 2). Kur personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij Kodi, vendimi arsyetohet brenda 15 ditëve nga data në të cilën është shpallur ose brenda 30 ditëve kur është gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (pika 3). Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, si më lart, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatës.

¹²³ Skrame, Olti, “Komunikimi i publikut me drejtësinë dhe institucionet e mbyllura. Sekretet hetimor dhe përgjegjësia që rrjedh prej tij.” fq.10
https://admin.magjistratura.edu.al/uploads/Materiali_trajnimi_i_dates_14_06_23_Olti_Skrame_3_a7a1551964.d

¹²⁴ Po aty.

Referuar Rregullores për Marrëdhëniet e Gjykatës me Publikun, miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 6777/5, datë 30 shtator 2010, “për miratimin e Rregullores” përcaktohet se vendimet e gjykatave të çdo niveli bëjnë pjesë në kategorinë e informacionit që mund të merret pakufizim. Këshu, në seksionin 4.1, pika e saktësohet se në faqen e zyrtare të çdo gjykate duhet të publikohen “Të gjitha vendimet përfundimtare, të marra nga gjykata, duke saktësuar nëse ka marrë apo jo formë të prerë”.¹²⁵

Në këtë mënyrë, publikimi i vendimeve të gjykatave i lejon publikut, shtypit, organizatave të shoqërisë civile dhe studiuesve të shqyrtojnë veprimet e gjykatave. Shqyrtimi i vendimeve të gjykatave nga publiku nëpërmjet publikimit të tyre rregullon zbatimin e ligjit dhe i bën vendimet e gjykatave me konsistente duke rritur në këtë mënyrë cilësinë e gjykimeve.¹²⁶ Në këtë kontekst, transparencja e gjyqësorit “rrit efikasitetin dhe promovon besimin sistemin e drejtësisë si dhe në administrimin e drejtësisë”.¹²⁷

3.2 Rëndësia e transparencës së proceseve gjyqësore

Transparenca e proceseve gjyqësore dhe aksesit i lirë i publikut janë faktorë kyç që ndikojnë drejtëpërdrejtë në promovimin e llogaridhënies dhe rritjen e besimit në sistemin gjyqësor. Përmes transparencës, sistemi gjyqësor bëhet i hapur për publikun, duke i lejuar qytetarët të njohin më mirë funksionimin e tij dhe procedurat që ndjek duke rritur në këtë mënyrë njohuritë e publikuara rreth sistemit gjyqësor. Këto njohuri të thelluara janë të rëndësishme për të adresuar problemet kur ato ndodhin, pasi publiku mund të bëhet një aleat i fuqishëm në zbulimin e shkeljeve të sistemit të drejtësisë dhe në raportimin e tyre. Në të njëjtën kohë, transparencja zvogëlon mundësinë e praktikave korruptive,¹²⁸ pasi proceset gjyqësore janë të hapura për vlerësimin publik dhe mbikëqyrjen e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile, dhe si rezultat praktikave korruptive zbulohen dhe raportohen më lehtë. Kështu, transparencja dhe aksesit i lirë i publikut ndihmojnë në forcimin e sistemit gjyqësor dhe në dhënien e drejtësisë me më shumë integritet dhe përgjegjshmëri.

Për më tepër, “transparenca e sistemit gjyqësor rrit efikasitetin dhe efektivitetin e vetë sistemit si dhe inkurajon gjykatësit të veprojnë në mënyrë të drejtë, të njëtrajtshme dhe

¹²⁵ Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr.6777/5, datë 30 shtator 2010 për miratimin e Rregullores “Për marrëdhënien e gjykatës me publikun”, , titulli III, seksioni 4.1, germa e.

https://www.gjp.gov.al/Programi_i_Transparencës/Rregullore/RREGULLORE_P_R_MARR_DH_NIENEGJYKAT_S_ME_PUBLIKUN.html

¹²⁶ United Nations Office on Drugs and Crime, (2011) Resource Guide on Strengthening Judicial Integrity and Capacity, fq. 89.

¹²⁷ France, Guilherme. (2019), Transparenca e procedurave gjyqësore, Transparenca Ndërkombëtare, fq.1

¹²⁸ Transparenca Ndërkombëtare (2007), Rritja e transparencës së gjyqësorit, fq. 1.
https://images.transparencycdn.org/images/TI_Policy_Position_Judiciary_01.07.pdf

të pavarur”.¹²⁹ Nga ana tjetër, një nga mënyrat për sigurimin e njëtrajtshmërisë në praktikën gjyqësore është përmes publikimit online të vendimeve gjyqësore.¹³⁰

Raporti analitik i sistemit të drejtësisë në Shqipëri e njeh transparencën si një dimension të rëndësishëm të sistemit gjyqësor duke theksuar se “publiciteti i veprimtarisë gjyqësore, aksesit i publikut në drejtësi dhe hapja e kësaj veprimtarie ndaj shoqërisë përmes komunikimit me publikun janë ndër elementët substancial për një sistem gjyqësor transparent”.¹³¹ Për më tepër, transparenca e institucioneve gjyqësore është karakteristikë e regjimeve demokratike¹³² dhe mundet të kontribuojë në rritjen e pavarësisë së sistemit gjyqësor.¹³³

Gjithashtu, sikurse u theksua edhe më sipër, aksesit në informacionin e prodhuar nga gjykatat shërben për të rritur besimin e qytetarëve ndaj institucioneve të drejtësisë.¹³⁴ Jo vetëm kaq, por “aksesit i publikut në vendimet e gjyqësorit i jep mundësi publikut që të monitorojë nga afër punën e gjyqësorit, duke forcuar mekanizmin e llogaridhënies dhe përgjegjshmërinë e gjyqësorit”.¹³⁵

Në këtë kontekst, publikimi i plotë i vendimeve gjyqësore luan një rol të dyfishtë. Nga njëra anë, përmes marrjes dijeni të vendimeve gjyqësore arrihet ndërgjegjësimi dhe edukimi juridik i popullsisë. “Nëse personat kanë informacion mbi veprimtarinë e gjykatave, duke ditur si interpretohet dhe zbatohet ligji prej tyre, atëherë kanë mundësi ta zbatojnë atë praktikisht”.¹³⁶ Nga ana tjetër, vendimet transparente të gjykatave i ofrojnë publikut një kuptim gjithëpërfshirës të arsyesimit të vendimeve gjyqësore, gjë që mund të ndihmojë në identifikimin e parregullsive të mundshme duke u bërë kështu pengesë kundër vendimeve të njëanshme ose arbitrare. Kur gjyqtarët e dinë se vendimet e tyre do të shqyrtohen nga publiku, ata kanë më shumë gjasa të marrin vendime të paanshme dhe të mirëarsyetuara.

Transparenca e sistemit të drejtësisë theksohet edhe në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, ku nënvizohet se vizioni i strategjisë është “Sistem i drejtësisë i

¹²⁹ France, Guilherme. (2019), Transparenca e procedurave gjyqësore, Transparenca Ndërkombëtare, fq.1. <https://knowledgehub.transparency.org/helpdesk/transparency-of-court-proceedings>

¹³⁰ Këshilli i Evropës, Nxitja e transparencës së vendimeve gjyqësore dhe rritja e zbatimit kombëtar të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njëriut, <https://www.coe.int/en/web/national-implementation/tjeni>

¹³¹ Komisioni i posaçëm parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, Tiranë 2015, fq. 77.

¹³² Po aty.

¹³³ Balkan Investigative Reporting Network, Monitorimi i nivelit të transparencës së gjykatave në Shqipëri, Tiranë 2018, fq. 7.

¹³⁴ Po aty.

¹³⁵ Komisioni i posaçëm parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, Tiranë 2015, fq. 79.

¹³⁶ Skrame, Olti, “Komunikimi i publikut me drejtësinë dhe institucionet e mbyllura. Sekretit hetimor dhe përgjegjësia që rrjedh prej tij.” fq.10 https://admin.magjistratura.edu.al/uploads/Materiali_trajnimi_i_dates_14_06_23_Olti_Skrame_3_a7a1551964.doc

pavarur, llogaridhënës, i aksesueshëm, transparent dhe eficient që mborn të drejtat e njeriut dhe i shërben shoqërisë sipas standardeve evropiane”.¹³⁷ Më tej theksohet se ky vizion do të jetësohet ndër të tjera përmes “fuqizimin e transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane”.¹³⁸ Tregues i rezultateve të përmbushjes së qëllimit të mësipërm është “% e çështjeve gjyqësore për të cilat informacioni bazë është në dispozicion në internet dhe i përditësuar”, dhe për këtë janë përcaktuar si institucion përgjegjës KLGJ dhe gjykatat.¹³⁹

Ndërkohë, edhe vetë institucionet e drejtësisë e njohin rëndësinë e transparencës dhe rolin që ajo luan në besimin e publikut. Kështu, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në vendimi nr. 590, datë 26.11.2020, për miratimin e “Planit strategjik të komunikimit për sistemin gjyqësor” që në krye të herës thekson se “Këshilli i Lartë Gjyqësor është i angazhuar për rikthimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor, si një ndër objektivat e tij kryesorë”. Më tej theksohet se “misioni i KLGJ është të ndërtojë, udhëheqë dhe qeverisë një sistem gjyqësor me performancë të lartë, që kërkon përsosmëri dhe meriton besimin e publikut”.¹⁴⁰ Edhe në faqen zyrtare të KLGJ-së, theksohet se “Këshilli i jep rëndësi ofrimit të informacionit për publikun dhe për këtë arsye po punohet me partnerët ndërkombëtarë për zhvillimin e një portali gjyqësor, si pjesë e një strategjie afatgjatë që synon rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së gjyqësorit para qytetarëve. Më tej theksohet se “qëllimi ynë [i KLGJ] është rritja e besimit të publikut në sistemin gjyqësor përmes rrugëve dhe mjeteve të reja të komunikimit”.¹⁴¹ Mirëpo, ende një portal i tillë nuk është bërë funksional, dhe gjykatat e posaçme nuk i publikojnë vendimet e tyre. Për më tepër, nuk evidentohet ngritja e mekanizmave që do të verifikonin nëse vendimet botohen apo jo, si botohen, dhe sa sa shpejt botohen dhe publikohen.

Ndërkohë, tek “Plani strategjik dhe plani i veprimit për zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2022”, në kreun e dytë, seksioni i vlerësimit të rrishtit, perceptimi negativ i publiku për sistemin e drejtësisë, është listuar njëkohësisht edhe tek dobësitë edhe tek kërcënimet.¹⁴² Kështu ILD konstaton se sistemit gjyqësor i mungon transparenca, dhe që kjo transparencë e munguar përkthehet në besueshmëri më të ulët nga publiku.

Edhe vetë Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila siç u theksua më sipër, nuk i ka të publikuara në faqen e saj zyrtare të gjitha vendimet e

¹³⁷ VKM, Nr. 823, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 dhe të planit të saj të veprimit”.

¹³⁸ Po aty.

¹³⁹ Po aty.

¹⁴⁰ Këshilli i Lartë Gjyqësor, Vendim nr. 590, datë 26.11.2020, Për miratimin e “Planit Strategjik të komunikimit të sistemit gjyqësor”.

¹⁴¹ <https://klgj.al/>

¹⁴² Inspektori i Lartë i Drejtësisë, “Plani Strategjik i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2022”, fq. 12.

dhëna për vitin 2022, në raportin e saj vjetor për të njëjtin vit thekson: “Një sistem gjyqësor që funksionon mbi bazën e parimit të pavarësisë, paanshmërisë, profesionalizmit, transparencës dhe barazisë së individëve para ligjit, meriton besimin e publikut!”¹⁴³

Në këtë mënyrë, gjykata në fjalë, duke mos publikuar në mënyrë të përgjithshme vendimet e saj për vitin 2022, i ka neglizhuar parimet që vetë i ka theksuar në raportin e vjetor. Kjo gjykatë në analizën vjetore të punëns nën titullin “Mesazhi kryesor” (seksioni 4.1), thekson se një sistem gjyqësor i bazuar mbi parimet e profesionalizmit dhe transparencës meriton besimin e publikut. Por rritja e besimit të publikut mbetet një slogan bosh vendimet e saj nuk i bëhen të njohura publikut ndaj të cilit pritet besim. Duke mos publikuar vendimeve, e kundërta ndodh pasi gjykata thellon ndjenjën e mos besimit në sistemin gjyqësor.

3.3 Aksesimi në kopjet e vendimeve gjyqësore dhe mbrojtja e të dhënave personale

Sikurse u theksua edhe më sipër, në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, një ndër treguesit e përmbushjes së fuqizimit të transparencës është “% e çështjeve gjyqësore për të cilat informacioni bazë është në dispozicion në faqen në internet dhe i përditësuar.”¹⁴⁴ Mirëpo, publikimi i vendimeve të gjykatave në faqen në internet nxjerr në pah një çështje tjetër themelore, atë të mbrojtjes së të dhënave personale.

Ndonëse Kushtetuta ka parashikuar se vendimet gjyqësore “shpallen publikisht në çdo rast” (neni 146, pika 2), ligjet dhe aktet nënligjore kanë sjellë problematika në lidhje me kufizimin e aksesit në vendimet gjyqësore, si dhe në kufizimin e përmbajtjes së tyre, përmes procesit të ashtuquajtur “anonimizim”.¹⁴⁵ Kështu, sipas nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 33/2022, datë 31.03.2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, “anonimizimi” është procesi “i ndryshimit të dokumenteve në mënyrë që dokumenti të mos lidhet me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm, ose procesi i bërjes së të dhënave personale anonime, në mënyrë që subjekti i të dhënave të mos jetë më i identifikueshëm”. Ky ligj, sipas neneve 1, 2, 3 dhe 4 të tij, parimisht gjen zbatim edhe për dokumentat gjyqësore, siç janë vendimet e gjykatave, apo

¹⁴³ Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Analiza vjetore e punës 2022, fq. 17.

¹⁴⁴ VKM, Nr. 823, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 dhe të planit të saj të veprimt”. https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/VKM-Nr.823-dat%C3%AB-24.12.2021-e-bashkuar_compressed.pdf

¹⁴⁵ Skrame, Olti, “Komunikimi i publikut me drejtësinë dhe institucionet e mbyllura. Sekretet hetimor dhe përgjegjësia që rrjedh prej tij.” fq.10 https://admin.magjistratura.edu.al/uploads/Materiali_trajnimi_i_dates_14_06_23_Olti_Skrame_3_a7a1551964.doc

procesverbalet e seancave apo të veprimeve gjyqësore. Ndaj, në praktikë, anonimizimi i vendimeve gjyqësore, pretendohet se, është i bazuar në ligj.¹⁴⁶

Ndërkohë, sipas udhëzimit të ministrit të Drejtësisë, nr. 4059/2, datë 07.06.2016 “Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave”, theksohet se vendimet gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë dhe të apeleve, përpara se, të hidhen në portalin elektronik të vendimeve, duhet të anonimizohen duke fshirë disa të dhëna të cilat specifikohen në udhëzim¹⁴⁷.

Nga ana tjetër, sipas udhëzimit nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kreu IV “Publikimi i të dhënave personale”, pika 4, theksohet se personat përgjegjës, gjatë publikimit të vendimeve penale në faqen zyrtare në internet, detyrohen të zbatojnë rregulla për mbrojtjen e privatësisë. Për më tepër, aksesimi në vendimin e plotë të publikuar në faqen zyrtare në internet, lejohet vetëm për personat që kanë një interes të ligjshëm në të (pika 8), si dhe kopja fizike e vendimit gjyqësor i jepet vetëm personave të interesuar që kanë interes të ligjshëm në lidhje me çështjen gjyqësore (pika 9).

Si rezultat, “dy aktet nënligjore të sipërpërmendura sjellin probleme kushtetuese”¹⁴⁸ të cilave ju shtohen një sërë problematikash teknike që sjellin pasoja në lidhje me anonimizimin e vendimeve gjyqësore dhe për pasojë me gjasa sjellin vonesa në publikimin e vendimeve gjyqësore në internet.

Aktualisht, vendimet gjyqësore hidhen në sistemin ICMIS, në rubrikën përkatëse. Sistemi mirëmbahet dhe administrohet nga KLGJ-së, së bashku me portalin e gjykatave (gjykata.gov.al). Anonimizimi kryhet automatikisht nga sistemi. Sapo vendimi hidhet në sistemin ICMIS, të dhënat që duhet të anonimizohen, identifikohen dhe anonimizohen automatikisht. Në këtë mënyrë, në portalin e gjykatës, vendimi del i anonimizuar.¹⁴⁹ Një problematikë që haset në anonimizimin e të dhënave në mënyrë automatike nga sistemi është se, ky i fundit identifikon të dhënat personale si p.sh. emrin e palës, por në brendësi

¹⁴⁶ Po aty.

¹⁴⁷ Referuar udhëzimit, vendimet duhet të anonimizohen, duke u fshirë: I) gjeneralitetet e palëve, personave të tretë, dëshmitarëve dhe ekspertëve të thirrur në gjykim; II) të dhënat e tjera që sjellin cenim të privatësisë së palëve në gjykim, si adresa, targa e makinës, numrat e telefonit, si dhe “çdo element tjetër i cili identifikon subjektin e të dhënave”; III) gjeneralitetet e ortakëve ose aksionarëve, përqindjet e aksioneve ose të kuotave që ato zotërojnë, numrat e llogarive bankare, shumat monetare dhe sekretet tregtare; IV) të dhënat e lidhura me të tretët, “nga të cilat mund të zbulohet, edhe indirekt, identiteti i të miturit, në rastet kur ky i fundit është palë në gjykim”; si dhe V) “çdo e dhënë tjetër që cenon dinjitetin dhe jetën private të palëve, ose të personave të tjerë të lidhur me çështjen gjyqësore”.

¹⁴⁸ Skrame, Olti, “Komunikimi i publikut me drejtësinë dhe institucionet e mbyllura. Sekretet hetimor dhe përgjegjësia që rrjedh prej tij.” fq.12

https://admin.magjistratura.edu.al/uploads/Materiali_trajnimi_i_dates_14_06_23_Olti_Skrame_3_a7a1551964.d

OC

¹⁴⁹ Po aty, fq 12.

të vendimit, emri i palës ndryshon për shkak të lakimit, apo rasave. Në këtë rast, sistemi e ka të vështirë t'i identifikojë këto të dhëna, e për pasojë ato dalin jo të anonimizuar.¹⁵⁰

Për më tepër, lidhur me masën e anonimizimit, pavarësisht masave të marra nga KLGJ-ja, ka raste kur vendimi i bërë publik në media, nga gjykata, është “kundërshtuar” prej tyre, me pretendimin se është i anonimizuar në atë masë, sa nuk mund të deshifrohet dhe nuk mund të përdoret për qëllimet e veprimtarisë mediatike. Asnjë ligj apo akt nënligjor nuk përcakton në mënyrë të qartë dhe të shprehur se, cilat janë elementet fikse që duhet të anonimizohen dhe në çfarë mase.¹⁵¹ Gjithashtu, nuk ka ndonjë parashikim të shprehur se cili është personi përgjegjës që duhet të vendosë mbi masën e anonimizimit. Kjo vendimarrje vlerësohet se nuk mund të ngelet vetëm nën përgjegjësinë e koordinаторit të autoritetit publik (gjykatës), por duhet që lidhur me masën e anonimizimit, të ketë rol përcaktues gjyqtari i medias.¹⁵²

Në analizën vjetore të punës së GJKKO për vitin 2022, evidentohet problemi me anonimizimin e vendimeve voluminoze gjyqësore të cilat kryen në mënyrë manuale. GJKKO-ja thekson domosdoshmërinë e zëvendësimit të procesit manual të anonimizimit të vendimeve voluminoze gjyqësore¹⁵³, nëpërmjet bashkëpunimit me KLGJ-në dhe përdorimit të metodave të tjera efikase me mjete teknologjike si dhe e zhvillimit të programit ARK IT, për të bërë të mundur anonimizimin e vendimeve gjyqësore të dhëna nga GJKKO.¹⁵⁴

3.4 Digjitalizimi i munguar

Përdorimi i teknologjisë së informacionit konsiderohet një nga elementët kryesorë për të përmirësuar administrimin e drejtësisë.¹⁵⁵ Referuar Opinione Nr. 14 (2011) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), “teknologjia e informacionit duhet të jetë një mjet për të përmirësuar administrimin e drejtësisë, lehtësuar qasjen e përdoruesve në gjykata dhe të përforcojë garancitë e parashtruara në nenin 6 të KEDNJ: akses në drejtësi, paanshmëri, pavarësi e gjyqtarëve, drejtësi dhe kohëzgjatja e arsyeshme e gjykimeve”.¹⁵⁶ Përdorimi i drejtë i teknologjisë së informacionit “është një element thelbësor i funksionimit të sistemeve gjyqësore dhe mund të kontribuojë në rritjen e transparencës,

¹⁵⁰ Po aty, fq. 12.

¹⁵¹ Po aty, fq. 12.

¹⁵² Po aty, fq. 12.

¹⁵³ Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Analiza vjetore e punës 2022, fq. 69.

¹⁵⁴ Po aty, fq. 42.

¹⁵⁵ Për më tepër shiko: Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2003) 14 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi ndërveprimin e sistemeve të informacionit në sektorin e drejtësisë.

¹⁵⁶ Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë, Opinion Nr. 14 (2011), “Drejtësia dhe teknologjia e informacionit”. <https://rm.coe.int/168074816b>

efiçencës, askesit dhe cilësisë së shërbimeve të dhëna”.¹⁵⁷ Referuar të dhënave të CEPEJ, Shqipëria mbetet një nga vendet me buxhetin më të ulët të alokuar për teknologjinë e informacionit në gjyqësor.¹⁵⁸ Për vitin 2022 vetëm 0,8% e buxhetit të gjykatave u shpenzua për kompjuterizim,¹⁵⁹ duke shënuar rënie krahasuar me një vit më parë kur buxheti i shpenzuar për këtë zë ishte 1.6%.¹⁶⁰ Përkatësisht, për vitin 2022, Shqipëria shpenzoi 25,708,104 Euro për gjykatat, nga të cilat 216,391Euro të buxhetit shkuan për kompiuterizimin (invesime në kompiuterizim dhe mirëmbajtje e pajisjeve të TI për gjykatat).¹⁶¹ Ndërsa për vitin 2021, Shqipëria shpenzoi 22,803,909 Euro për gjykatat, nga të cilat 353,544 Euro të buxhetit shkuan për kompiuterizim (invesime në kompiuterizim dhe mirëmbajtje e pajisjeve të TI për gjykatat).¹⁶²

Ndërkohë, sipas një vlerësimi të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), lidhur me gjendjen e digjitalizimit të drejtësisë në Ballkanin Perëndimor, Shqipëria ka hasur probleme me përdorimin e dy sistemeve paralele të menaxhimit të rasteve (CMS), përkatësisht ARK/IT dhe ICMIS dhe ndonëse KLGJ ka marrë vendimin strategjik të zëvendësimit me një sistem të ri CMS që përfshin e-komunikimin, ende nuk ka përparim.¹⁶³ Për më tepër, gjykatat e Shqiptare nuk kanë qasje në mjete të cilat do të mundësonin shkëmbimin e sigurtë të të dhënave digjitale mes tyre, për pasojë shkëmbimi i dokumentacionit mes autoriteteve realizohet vetëm përmes transferimit të dosjeve fizike.¹⁶⁴

Shpenzimet e kufizuara për kompiuterizim, si për investime në kompiuterizim ashtu dhe për mirëmbajtje të pajisjeve të TI për gjykatat mund të rezultojë në performacë të kufizuar të sistemit duke shkaktuar vonesa në anonimizimin dhe publikimin më pas të vendimeve gjyqësore.

¹⁵⁷ Këshilli i Evropës, (2022), Raport vlerësimi i sistemit gjyqësor Evropian CEPEJ, Cikli i vlerësimit 2022 (të dhënat 2020), fq. 111

¹⁵⁸ Po aty, fq. 113

¹⁵⁹ Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), (2023), HFIII: Drejt një vlerësimi më të mirë të rezultateve të përpjekjeve për reformën gjyqësore në Ballkanin Perëndimor “Dashboard për Ballkanin Perëndimor”, Mbledhja e të dhënave: 2022, Pjesa 2 (A) – Fisha e përfituesit – Shqipëria, fq. 5

¹⁶⁰ Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), (2022), HFIII: Drejt një vlerësimi më të mirë të rezultateve të përpjekjeve për reformën gjyqësore në Ballkanin Perëndimor “Dashboard për Ballkanin Perëndimor”, Mbledhja e të dhënave: 2021, Pjesa 2 (A) – Fisha e përfituesit – Shqipëria, fq. 5

¹⁶¹ Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), (2023), HFIII: Drejt një vlerësimi më të mirë të rezultateve të përpjekjeve për reformën gjyqësore në Ballkanin Perëndimor “Dashboard për Ballkanin Perëndimor”, Mbledhja e të dhënave: 2022, Pjesa 2 (A) – Fisha e përfituesit – Shqipëria, fq. 5

¹⁶² Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), (2022), HFIII: Drejt një vlerësimi më të mirë të rezultateve të përpjekjeve për reformën gjyqësore në Ballkanin Perëndimor “Dashboard për Ballkanin Perëndimor”, Mbledhja e të dhënave: 2021, Pjesa 2 (A) – Fisha e përfituesit – Shqipëria, fq. 5

¹⁶³ Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, (2022), Hartëzimi i gjendjes së digjitalizimit të drejtësisë në Ballkanin Perëndimor, Fq.33. <https://www.rcc.int/pubs/135/mapping-the-state-of-play-of-digitalisation-of-justice-in-the-western-balkans>

¹⁶⁴ Po aty, fq. 14-15.

Ndërkohë, KLGJ ka miratuar planin strategjik 2022-2024, ku “mungesa e sistemeve të dobishme të teknologjisë së informacionit në gjykata”¹⁶⁵ identifikohet si një dobësi e sistemit gjyqësor si dhe ka parashkikuar hapat që do të ndërmerren për përmbushjen e synimeve, përfshi edhe adresimin e problemit “të sistemeve të vjetëruara dhe jofunksionale të teknologjisë së informacionit”.¹⁶⁶ Në këtë aspekt, synohet mirëmbajtja dhe zhvillimi i një sistemi të elektornik të unifikuar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore si dhe vënia në funksionim të plotë të Qendrës së TI-së në sistemin e Drejtësisë¹⁶⁷, e cila do të vendosë standardet dhe politikat për funksionimin efektiv të teknologjisë së përpunimit të informacionit dhe sistemeve të të dhënave (hardware dhe software) për sistemin e drejtësisë¹⁶⁸.

Adresimi i problemeve të lidhura me TI-në në sistemin gjyqësor do të zbuste problemi me anonimizimin e vendimeve voluminoze gjyqësore të cilat kryen në mënyrë manuale nga GJKKO dukë zvogëluar në këtë mënyrë kohën e publikimit të vendimeve gjyqësore.

3.5 Ngarkesa në punë e gjyqtarëve

Gjatë vitit 2020, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar veproi me 11 gjyqtarë nga 16 që është numri minimal sipas ligjit¹⁶⁹. Ndërkohë, për të njëjtin vit Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar veproi me 6 gjyqtarë nga 11 që është numri minimal i lejuar.¹⁷⁰ Gjatë vitit 2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar funksionoi me 45% të organikës së gjyqtarëve, duke pasur 7.16 gjyqtarë efektivisht në detyrë.¹⁷¹ Ndërkohë, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pati një “ulje të numrit efektiv të gjyqtarëve nga 5.4 në 4.58 duke funksionuar me 42% të organikës së gjyqtarëve.¹⁷² Ndërsa për vitin 2022, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar funksionoi me 47% të organikës së gjyqtarëve duke pasur 7.5 gjyqtarë efektivisht në

¹⁶⁵ Këshilli i Lartë Gjyqësor, Plani Strategjik i Këshillit të Lartë Gjyqësor për Sistemin Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë 2022-2024, fq. 10. <https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/05/Plani-Strategjik-Final-2022-2024.pdf>

¹⁶⁶ Po aty, fq. 12.

¹⁶⁷ Po aty, fq. 14.

¹⁶⁸ Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, (2022), Hartëzimi i gjendjes së digitalizimit të drejtësisë në Ballkanin Perëndimor, Fq.33. <https://www.rcc.int/pubs/135/mapping-the-state-of-play-of-digitalisation-of-justice-in-the-western-balkans>

¹⁶⁹ Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raport mbi ecurinë e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020, fq. 62. <https://klgj.al/2021/06/raporti-vjetor-klgj-2020/>

¹⁷⁰ Po aty.

¹⁷¹ Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raport mbi ecurinë e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2021, fq. 42. <https://klgj.al/2022/04/raporti-vjetor-klgj-2021/>

¹⁷² Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raport mbi ecurinë e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2021, fq. 47-48. <https://klgj.al/2022/04/raporti-vjetor-klgj-2021/>

detyrë.¹⁷³Ndërkohë, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar operoi me 7.91 gjyqtarë efektivisht në detyrë duke funksionuar me 72% të organikës së gjyqtarëve.¹⁷⁴

Nga ana tjetër, për vitin 2022 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar rregjistroi 2059 çështje të reja, ose 144 çështje më pak krahasuar me vitin 2021.¹⁷⁵Referuar raportit të KLGJ-së rritja e numrit efektiv të gjyqtarëve për këtë vit solli edhe një ulje të ngarkesës mesatare për gjyqtar me 31 çështje¹⁷⁶. Megjithatë, kjo nuk ka rezultuar në rritjen e numrit të çështjeve vendimet përfundimtare të të cilave janë publikuar në faqen në internet të gjykatës.

Vakancat dhe numri i madh i çështjeve dhe kompleksiteti i tyre ka sjellë vonesa të kuptueshme në procesin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore nga kjo gjykatë. Në një prononcim për mediat, Inspektori i Lartë i Drejtësisë u shpreh se ndonëse vonesat në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara përbëjnë një shkelje të mundshme disiplinore, që këto shkelje të konsiderohen si të tilla, duhe të ketë një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhence apo mungese aftësie profesionale, të tilla që kalojnë “kufirin e të arsyeshmes”.¹⁷⁷ Për më tepër, theksohet se që të arrihet “në konkluzionin, nëse nga ana e magistratëve janë ndërmarrë veprime/mosveprime, të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore duhet të analizohen rast pas rasti”.¹⁷⁸

Ndërkohë, ILD nuk ka realizuar ende një inspektim “rast pas rasti” lidhur me vonesat për procedurën e shpalljes së vendimeve gjyqësore dhe publikimit të tyre për gjykatat e posaçme për vitin 2022.

3.6 Inspektimet tematike për mospublikim të vendimeve

Kushtetuta në Nenin 147/d, parashikon se: “Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj”.

Në mbështetje të nenit 194, pika 4 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është organi përgjegjës

¹⁷³ Këshilli i Lartë Gjyqësor. Raport mbi ecurinë e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022, fq. 65. <https://klgj.al/2023/07/raporti-vjetor-klgj-2021-2/>

¹⁷⁴ Po aty, fq. 61.

¹⁷⁵ Po aty, fq. 69.

¹⁷⁶ Po aty.

¹⁷⁷ <https://ild.al/sq/2023/10/06/perfundon-inspektimi-tematik-ne-dy-gjykata-te-tiranes-per-proceduren-e-shpalljes-dhe-arsyetimit-te-vendimeve-gjyqesore/>

¹⁷⁸ Po aty.

për kryerjen e inspektimeve institucionale dhe tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë. ILD mund të vihet në lëvizje për hetime jo vetëm bazuar në ankesa por edhe kryesisht. Për më tepër, tek “Plani strategjik dhe plani i veprimit për zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2022”, thuhet: “Rritja e transparencës dhe konsolidimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë do të arrihet nëpërmjet rritjes së profesionalizmit dhe përmbushjes së detyrave përmes inspektimeve të gjykatave/prokurorive, si dhe krijimit të mundësive të publikut për t’u njohur me kuadrin ligjor.¹⁷⁹”

Më herët, një nga gjetjet e raportit të vlerësimit të grupit të ekspertëve të lartë për sistemin e drejtësisë në Shqipëri, në vitin 2015, ishte se “vendimet shpallen të paarsyetuara, shpallet vetëm dispozitivi i vendimit si dhe nuk arrihet të respektohen afatet procedurale për shpalljen”.¹⁸⁰ Ndonëse kanë kaluar 8 vite nga ky raport situata mbetet e njëjtë. Vendimet nuk shpallen në kohë dhe ato që shpallen në faqen zyrtare të internetit të gjykatave janë të publikuara në rastin më të mirë vetëm dispozitivët.

Në raportin “Për punën e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, raportohet se ka filluar hetimi disiplinor sipas ligjit nr. 96/2016, neni 102, pika 1, shkronja e, për “vonesa dhe zvarritja e përsëritur dhe e pajustificuar e veprimeve procedurale dhe e nxjerrjes së akteve gjatë ushtrimit të funksionit të magjistratit”¹⁸¹ por duke mos saktësuar numrin e magjistratëve të hetuar për këtë pikë dhe as statusin e hetimit. Gjatë periudhës në fjalë ILD ka kryer dy inspektime tematike, asnjë prej të cila nuk është lidhur me mospublikimin e vendimeve në faqen e gjykatave.

Ndërkohë, në tetor 2023, ILD përfundoi inspektimin tematik në dy gjykata të Tiranës,¹⁸² “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore”. Arsyeja e kryerjes së inspektimit, referuar raportit të inspektimit të ILD-së është “numri i lartë i ankesave të paraqitura pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në të cilat ngriheshin pretendime për vonesa në zbardhjen e vendimeve gjyqësore përtej afateve ligjore”.¹⁸³ Në raport theksohet se për të konkluduar nëse një magjistrat ka ndërmarrë veprime apo

¹⁷⁹ Inspektori i Lartë i Drejtësisë, “Plani Strategjik i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2022, fq. 13.

¹⁸⁰ Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, 2015, fq. 80.

https://www.reformanedrejtisi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf

¹⁸¹ Ligj Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

¹⁸² ILD inspektoi Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Tiranë, (dhoma civile) dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për periudhën 1 shtator deri më 31 dhjetor 2022.

¹⁸³ Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, 29.09.2023, Raport i inspektimit, “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, (Dhoma civile) dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, fq.3.

<https://ild.al/sq/2023/10/06/perfundon-inspektimi-tematik-ne-dy-gjykata-te-tiranes-per-proceduren-e-shpalljes-dhe-arsyetimit-te-vendimeve-gjyqesore/>

mosveprime të cilat përbëjnë shkelje disiplinore, duhen marrë në konsideratë paraprakisht fakti që gjykatat funksionojnë me kapacitet të reduktuar, dhe ngarkesa e punës për gjyqtar është më e lartë se norma evropiane.¹⁸⁴

Sikurse u theksua edhe më sipër, ILD nuk ka kryer ndonjë inspektim tematik lidhur me vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore në GJKKO për vitin 2022. Ndonëse, të dy argumentet e mësipërme të ILD-së vlejnë edhe për gjykatat e posaçme, vonesat përtej “kohës së arsyeshme” në publikimin e vendimeve përfundimtare janë tregues i mjaftueshëm për të filluar procedura për verifikimin e problemit apo edhe hetim disiplinor për personat përgjegjës.

3.7 Institucionet përgjegjëse për monitorimin e transparencës

Sikurse është theksuar edhe më sipër, mungesa e transparencës shfaqet në shumicën e institucioneve të shqyrtuara në këtë raport. Disa prej tyre bëjnë publikim të pjesshëm të të dhënave dhe disa nuk publikojnë asnjë informacion. Megjithatë, asnjë nga institucionet përgjegjëse për qeverisjen e sistemit të drejtësisë nuk e ka ngritur problemin e mospublikimit të të dhënave dhe nuk ka marrë masa për korrigjimin e kësaj problematike dhe për mospërsëritjen e saj.

Kështu, në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, një ndër treguesit e performancës me të cilët matet fuqizimi i transparencës është “% e çështjeve gjyqësore për të cilat informacioni bazë është në dispozicion në faqen në internet dhe i përditësuar.”¹⁸⁵ Në raportin e monitorimit të strategjisë për vitin 2022, nënvizohet se “për 100% të çështjeve gjyqësore informacioni bazë është i disponueshëm online dhe i përditësuar dhe mund të aksesohet në platformën virtuale (www.gjykata.gov.al),¹⁸⁶ Në këtë mënyrë, targeti konsiderohet i arritur plotësisht.¹⁸⁷ Mirëpo nëse hyn në platformën e mësipërme në menunë Gjykatat shqiptare/Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk nuk gjendet asnjë informacion në asnjërën prej rubrikave.

Në këtë kontekst, Ministria e Drejtësisë, si institucioni përgjegjës për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 nuk ka

¹⁸⁴ Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, 29.09.2023, Raport i inspektimit, “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, (Dhoma civile) dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, fq.9.

<https://ild.al/sq/2023/10/06/perfundon-inspektimi-tematik-ne-dy-gjykata-te-tiranes-per-proceduren-e-shpalljes-dhe-arsyetimit-te-vendimeve-gjyqesore/>

¹⁸⁵ VKM, Nr. 823, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 dhe të planit të saj të veprimit”. https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/VKM-Nr.823-dat%C3%AB-24.12.2021-e-bashkuar_compressed.pdf

¹⁸⁶ Ministria e Drejtësisë, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025, Raporti i monitorimit 2022, fq 58, <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/Raporti-i-Monitorimit-2022.pdf>

¹⁸⁷ Po aty

ndërmarrë ndonjë hap apo masë për ta adresuar problemin e rënies së transparencës në dy vitet e fundit.

Ndërkohë, Këshilli i Lartë Gjyqësor në raportin vjetor për vitin 2022, nuk e identifikon si shqetësuese faktin e mospublikimit të vendimeve nga Gjykatat e Posaçme. Për pasojë KLGJ nuk ka marrë masa për të korrigjuar problematikat me transparencën dhe të monitorojë sistematikisht zbatimin e kuadrit ligjor dhe strategjik për transparencën.

Nga ana tjetër, sikurse u theksua edhe më sipër Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka kryer inspektive tematike lidhur me mospublikimin e vendimeve nga gjykatat e posaçme, si dhe nuk ka marrë ndonjë masë disiplinore apo tjetër ndaj institucioneve respektive për mospublikimin e vendimeve sipas legjislacionit dhe afateve të përcaktuara.

Ndërkohë, gjatë raportimit vjetor të KLP, KLGJ dhe ILD në Kuvend, fjala transparencë është përmendur vetëm tre herë. Shqetësuese për deputetët ka qenë mospublikimi i procesverbaleve të KLGJ-së kur bëhet fjalë për promovimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë,¹⁸⁸ prokurorëve apo promovime të tjera në sistemin gjyqësor.¹⁸⁹ Gjithashtu, është folur në terma të përgjithshme se “efiçenca, llogaridhënia, transparenca me publikun” duhet të jetë kryefjalë e sistemit të drejtësisë. Në asnjë rast, Kuvendi nuk e ka indentifikuar apo ngritur si problem mungesën e transparencës gjatë raportimit vjetor të KLP, KLGJ, dhe ILD, çka tregon për një mungesë të fokusit dhe vëmendjes ndaj transparencës.

Nga ana tjetër, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i cili mat indeksin e transparencës proaktive të institucioneve qëndrore të varësisë, monitoron KLGJ dhe SPAK por jo gjykatat e posaçme.¹⁹⁰ Për më tepër, asnjë prej indikatorëve nuk ka në fokus të monitorimit publikimin apo mospublikimin e vendimeve të gjykatave. Në këtë kontekst, edhe ky institucion nuk e ka patur në fokus monitorimin e zbatimit efikas të transparencës së institucioneve të drejtësisë.¹⁹¹

¹⁸⁸ Kuvendi, Legjislatura X – Seanca e ditës së hënë. 3 korrik 2023, Tiranë, Procesverbal, fq. 17

¹⁸⁹ Po aty, fq. 44

¹⁹⁰ Indeksi i transparencës proaktive të institucioneve qëndrore të varësisë monitoron shtatë tregues: (1) Publikimi i Programit të Transparencës së Rishikuar për Autoritetet Publike sipas urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020, “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, (2) Të dhënat e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, (3) Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve i përditësuar gjatë vitit 2022, sipas urdhrit nr. 188, dt. 18.12.2020, “Për miratimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të Rishikuar” (4) Publikimi i të dhënave për buxhetin, për vitin financiar 2022, (5) Publikimi i raporteve të auditimit dhe monitorimit (psh Raporte KLSH ose Raporte Auditit të Brendshme), (6) Publikimi i Cv së titullarit, (7) Publikimi i strukturës së Autoritetit Publik.

¹⁹¹ Lgji nr. 119/2014, Për të drejtën e informimit

IV: Konkluzione dhe rekomandime

Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar përbën një nga sfidat dhe njëkohësisht prioritet kryesor të Shqipërisë për ecurinë e procesit të integritetit në Bashkimin Evropian. Monitorimi i përvitshëm i performancës së Gjykatave të Posaçme dhe SPAK në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, synon të ofrojë një vlerësim sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës të efektivitetit të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Ashtu sikurse në raportet e mëparshme, ky vlerësim bazohet në indikatorë të matshëm në përputhje me specifikat e çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar të hetuara dhe gjykuara nga Prokuroria dhe Gjykatat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Indikatorët masin tre dimensionet kryesore përkatësisht: (i) produktivitetin, (ii) efikasitetin dhe (iii) relevancën, mbi bazën e të cilave vlerësohet efektiviteti i përgjigjes ndaj fenomeneve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në Shqipëri.

Përkundrejt këtij konteksti, raporti konstaton si më poshtë:

- Rastet e hetimeve për çështje të korrupsionit të zyrtarëve të lartë shtetërorë mbeten në nivele të ulëta (18 procedime penale me 18 të pandehur gjatë 2020 - 2022). Gjithashtu, vendimet e dënimit për ish-zyrtarë të nivelit të lartë mbeten të ulëta (4 vendime dënimi me 4 persona të dënuar gjatë vitit 2022).
- Organika e strukturave të posaçme ka mungesa të theksuara të personelit dhe numri i madh i çështjeve të marra në shqyrtim dhe kompleksiteti i tyre kanë shpënë në ulje të produktivitetit dhe efikasitetit, si dhe në vonesa në arsyetimin dhe publikimin e vendimeve gjyqësore.
- Mungesa e transparencës është shqetësuese dhe shfaqet në pjesën dërrmuese të institucioneve të marra në shqyrtim. Ekzistojnë mangësi të cilat lidhen me mungesën e informacionit, të dhënave të publikuara në faqet zyrtare të institucioneve të marra në shqyrtim apo probleme me përditësimin e tyre. Përkatësisht, lista e çështjeve në gjykim si edhe atyre të përfunduara nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitin 2022 është përditësuar deri në korrik të vitit 2022, ndërkohë që nuk ka informacion mbi çështjet për periudhën vijuese deri në fund të vitit 2022. Për më tepër, në faqen zyrtare të GJKKO-së gjenden të publikuara vetëm analiza vjetore për vitin 2021 dhe vitin 2022 por jo për vitin 2020. Nga ana tjetër, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk ka publikuar një analizë vjetore të punës për vitin 2022. Gjithashtu, Agjencia për Administrimit e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) nuk ka publikuar një raport për vitin 2022 si dhe nuk ka përditësuar tabelat integrale të

pasurive të sekuestruara për vitin 2021 dhe 2022. Për më tepër, mungon harmonizimi i të dhënave mes institucioneve të ndryshme të sistemit të drejtësisë.

- Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka marrë masa për të korrigjuar problematikat me transparencën dhe të monitorojë sistematikisht zbatimin e kuadrit ligjor dhe strategjik për transparencën.
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka kryer inspektime tematike lidhur me mospublikimin e vendimeve nga gjykatat e posaçme, si dhe nuk ka marrë ndonjë masë disiplinore apo tjetër ndaj institucioneve respektive për mospublikimin e vendimeve sipas legjislacionit dhe afateve të përcaktuara.
- Ministria e Drejtësisë, si institucioni përgjegjës për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 nuk ka ndërmarrë ndonjë hap apo masë për ta adresuar problemin e rënies së transparencës në dy vitet e fundit.
- Edhe Kuvendi nuk e ka indentifikuar apo ngritur si problem mungesën e transparencës gjatë raportimit vjetor të KLP, KLGJ, dhe ILD, çka tregon për një mungesë të fokusit dhe vëmendjes ndaj transparencës.
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjithashtu nuk i ka ushtruar kompetencat për monitorimin e zbatimit të transparencës sipas kërkesave të legjislacionit për të drejtën e informimit

Nisur nga këto gjetje, raporti rekomandon:

- Për aq sa problematika është e lidhur me mungesat në organikën e gjyqtarëve sipas numrit të përcaktuar me ligj, brenda kufizimeve që kjo situatë krijon duhet që të shqyrtohen dhe merren masa që të adresohet produktiviteti dhe efienca në performancën e SPAK dhe GJKKO.
- Shtimin e përpjekjeve për krijimin dhe bërjen sa më parë funksional të sistemit të menaxhimit të të dhënave për të siguruar ndërveprimin e tij në të gjithë sistemin e drejtësisë sipas metodologjisë së CEPEJ, çka do të rriste efiençën dhe transparencën e sistemit.
- Organet respektive duhet të adresojnë sa më shpejtë problemin e harmonizimit të të dhënave mes institucioneve të drejtësisë për të siguruar që informacioni të jetë konsistent dhe i përdorshëm për monitorimin e korrupsionit dhe veprimtarisë së institucioneve të drejtësisë.
- Në tërësi duhet të rishikohet qasja dhe të merren masa që të adresohet mungesa e transparencës dhe qasja e qytetarëve dhe e organizatave të shoqërisë civile ndaj vendimmarrjes së institucioneve gjyqësore.

- Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të marrë masa për të korrigjuar problematikat me transparencën dhe të monitorojë sistematikisht zbatimin e kuadrit ligjor dhe strategjik për transparencën.
- Zbatimi me rigorozitet i kuadrit për transparencën duhet të jetë në fokus të vëmendjes edhe të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke kryer inspektime tematike lidhur me shkaqet dhe përgjegjësitë e mospublikimit të vendimeve nga gjykatat, si dhe marrjen e masave respektive për korrigjimin e pasojave dhe krijimin e kushteve për mospërsëritjen e problemit.
- Ministria e Drejtësisë, për aq sa e lejojnë kompetencat dhe përgjegjësitë edhe në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 duhet të bëjë përpjekjet që i takojnë në lidhje me transparencën.
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë zbatimit të transparencës në institucionet e drejtësisë.
- Të adresohen problemet e lidhura me teknologjinë e informacionit në sistemin gjyqësor çka do të zbuste problemi me anonimizimin e vendimeve voluminoze gjyqësore të cilat kryen në mënyrë manuale nga GJKKO duke zvogëluar në këtë mënyrë kohën e publikimit të vendimeve gjyqësore.
- Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (shkalla e parë dhe apeli), të rishikojnë mundësinë për t'i dhënë prioritet publikimit të vendimeve lidhur me rastet e korrupsionit të profilit të lartë me qëllim rritjen e besimit të publikut.
- Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK) duhet të përditësojë dhe publikojë sa më parë raportet e aktivitetit të saj, si dhe tabelat integrale të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Ky veprim do të lejonte një ndjekje më të mirë të progresit, si dhe do të kontribuonte në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies publike në lidhje me këtë çështje të rëndësishme. Gjithashtu, të rishikohet qasja për zhvillimin e një sistemi të efektshëm të monitorimit dhe raportimit në këtë fushë, për të siguruar që ligji anti-mafia për sekuestrimin dhe konfiskimin parandalues të zbatohet me efikasitet dhe asetet kriminale ripërdoren në mënyrë që të përfitojnë shoqërinë në përgjithësi.
- Duke patur në vëmendje pritmëritë e publikut dhe problematikat me natyrë objektive të institucioneve, duhet të ndërmerren fushata sensibilizuese me qëllim ndërgjegjesimin e publikut dhe pjesëmarrjen në adresimin e problemave aty ku publiku mund të kontribuojë.

Bibliografia

- Balkan Investigative Reporting Network. (2018). Monitorimi i nivelit të transparencës së gjykatave në Shqipëri. Tiranë.
- Dyrmishi, A, Hallunaj, M. (shkurt 2021). *Raport Vlerësimi “Veprimtaria e Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar 2020”*. Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes. http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2021/03/Raport-Vleresimi_SPAK-Gjykatat-2020-FINAL-1.pdf.
- Faafeng, Jo et, al. (2013). Drejt drejtësisë. Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore. OSCE.
- France, Guilherme. (2019). *Transparenca e procedurave gjyqësore*. Transparenca Ndërkombëtare. <https://knowledgehub.transparency.org/helpdesk/transparency-of-court-proceedings>
- Freedom House. *Liria në botë 2022*. Shqipëria. <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2022>.
- Fjalimi i komisionerit Várhelyi në seancën plenare të 580-të të Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social - Debat mbi të ardhmen e shoqërisë civile në procesin e zgjerimit https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/speech_23_3827
- GRECO. Fifth Evaluation Round “Preventing corruption and promoting integrity in central governments (top executive functions) and law enforcement agencies”. <https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventingcorruption-and-promoting-integrity-i/1680a0923d>
- Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Analiza vjetore e punës 2022. http://www.gjp.gov.al/rc/doc/Analiza_Vjetore_e_punes_viti_2022_4814.pdf
- Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Analiza vjetore e punës 2021. http://www.gjp.gov.al/rc/doc/Analiza_vjetore_2021_GJKKO_4774.pdf.
- Hoxhaj, Andi. (2020). The EU Anti-Corruption Report. A Reflexive Governance Approach. Routledge.
- Hoxhaj, Edmond. (2023). *SPAK shënon rekorde në zvarritjen e hetimeve të korrupsionit në nivel të lartë*. BIRN. <https://www.reporter.al/2023/03/06/spak-shenon-rekorde-ne-zvarritjen-e-hetimeve-te-korrupsionit-ne-nivel-te-larte/>
- Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. *Sondazhi i opinionit publik 2022: Besimi në qeverisje*, Edicioni i 10-të. <https://idmalbania.org/publication-of-the-10th-edition-of-trust-in-governance-annual-public-opinion-poll-in-albania/>
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë. “Plani Strategjik i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2022”.

- Instituti i Studimeve Politike. (2018). *Reforma në Drejtësi: 2018, Bilanci, Problematikat, Sfidat*. <https://isp.com.al/wp-content/uploads/2019/01/REFORMA-NE-DREJTESI-ISP-RAPORT-2018.pdf>
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë. (2023). Raport i inspektimit, “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, (Dhoma civile) dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”. <https://ild.al/sq/2023/10/06/perfundon-inspektimi-tematik-ne-dy-gjykata-te-tiranes-per-proceduren-e-shpalljes-dhe-arsyetimit-te-vendimeve-gjyqesore/>
- Lgji nr. 119/2014. “Për të drejtën e informimit”
- Ligji 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.
- Ligj Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. (2022). *Hartëzimi i gjendjes së digjitalizimit të drejtësisë në Ballkanin Perëndimor*. <https://www.rcc.int/pubs/135/mapping-the-state-of-play-of-digitalisation-of-justice-in-the-western-balkans>
- Këshilli i Evropës. *Nxitja e transparencës së vendimeve gjyqësore dhe rritja e zbatimit kombëtar të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*. <https://www.coe.int/en/web/national-implementation/tjeni>
- Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë. Opinion Nr. 14 (2011). “*Drejtësia dhe teknologjia e informacionit*”. <https://rm.coe.int/168074816b>
- Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), Opinion Nr. 18 (2015), *Pozicioni i gjyqësorit dhe marrëdhëniet e tij me pushtetet e tjera në një demokraci moderne*. [https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=CCJE\(2015\)4&Language=lanEnglish&Ver=original&BackColorInternet=DBDCF2&BackColorIntranet=FDC864&BackColorLogged=FDC864](https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=CCJE(2015)4&Language=lanEnglish&Ver=original&BackColorInternet=DBDCF2&BackColorIntranet=FDC864&BackColorLogged=FDC864)
- Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), Opinion Nr. 24 (2021), *Evoluimi i Këshillave Gjyqësor dhe roli i tyre në sistemet gjyqësore të pavarura dhe pananshme*. <https://rm.coe.int/opinion-no-24-2021-of-the-ccje/1680a47604>
- Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ). (2023). *HFIII: Drejt një vlerësimi më të mirë të rezultateve të përpjekjeve për reformën gjyqësore në Ballkanin Perëndimor*. “Dashboard për Ballkanin Perëndimor”. Mbledhja e të dhënave: 2022. Pjesa 2 (A) – Fisha e përfituesit – Shqipëria.
- Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ). (2022). *HFIII: Drejt një vlerësimi më të mirë të rezultateve të përpjekjeve për reformën gjyqësore në Ballkanin Perëndimor*. “Dashboard për Ballkanin Perëndimor”. Mbledhja e të dhënave: 2021. Pjesa 2 (A) – Fisha e përfituesit – Shqipëria.
- Këshilli i Evropës. Rekomandimi (2003) 14 i Komitetit të Ministrave për shteteve anëtare mbi ndërveprimin e sistemeve të informacionit në sektorin e drejtësisë.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor. Vendim nr. 590, datë 26.11.2020. Për miratimin e “*Planit Strategjik të komunikimit të sistemit gjyqësor*”.

- Këshilli i Lartë Gjyqësor. Raport mbi ecurinë e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020. <https://klgj.al/2021/06/raporti-vjetor-klgj-2020/>
- Këshilli i Lartë Gjyqësor. Raport mbi ecurinë e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2021. <https://klgj.al/2022/04/raporti-vjetor-klgj-2021/>
- Këshilli i Lartë Gjyqësor. Raport mbi ecurinë e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022. <https://klgj.al/2023/07/raporti-vjetor-klgj-2021-2/>
- Këshilli i Lartë Gjyqësor. Plani Strategjik i Këshillit të Lartë Gjyqësor për Sistemin Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë 2022-2024. https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/05/Plani-Strategjik-Final_2022-2024.pdf
- Këshilli i Bashkimit Evropian. (25 March 2020) 7002/20. <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf>.
- Këshilli i Evropës. (2022). Raport vlerësimi i sistemit gjyqësor Evropian CEPEJ. Cikli i vlerësimit 2022 (të dhënat 2020).
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Raporti Vjetor 2022. <https://klp.al/wp-content/uploads/2023/05/Raporti-Vjetor-2022-2.docx>
- Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë. Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë. (2015) Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri. https://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf
- Komisioni Evropian. (2020). Përmirësimi i procesit të anëtarësimit – Një perspektivë e besueshme Evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enhancing-accession-process-credible-eu-perspective-ëestern-balkans_en
- Komisioni Evropian. (2023). Shqipëria Screening 2023. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en
- Komisioni Evropian. (2023). Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komisionin Ekonomik e Shoqëror Evropian dhe Komisionin e rajoneve. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/2023-communication-eu-enlargement-policy_en
- Kuvendi, Legjislatura X – Seanca e ditës së hënë. 3 korrik 2023, Tiranë, Procesverbal.
- Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes. Barometri i siguri së Shqipëri. Anketë Kombëtare 2022. <https://csdgalbania.org/albanian-security-barometer-2022/>
- Transparenca Ndërkombëtare. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2022. <https://www.transparency.org/en/cpi/2022/index/alb>.
- Transparenca Ndërkombëtare (2007). Rritja e transparencës së gjyqësorit. https://images.transparencycdn.org/images/TI_Policy_Position_Judiciary_01.07.pdf
- Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2021. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albaniareport-2021_en
- Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2022.. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en.

- Skrame, Olti. "Komunikimi i publikut me drejtësinë dhe institucionet e mbyllura. Sekretet hetimor dhe përgjegjësia që rrjedh prej tij." https://admin.magjistratura.edu.al/uploads/Materiali_trajnimi_i_dates_14_06_23_Olti_Skrame_3_a7a1551964.doc
- Sam van der Staak. (2023). Një fotografi e demokracisë në raportet e zgjerimit të vitit 2023. <https://www.idea.int/news/snapshot-democracy-2023-enlargement-reports>
- Roger K. Warren, Rëndësia e pavarësisë së gjyqësorit dhe llogaridhënia, <https://ncsc.contentdm.oclc.org/digital/collection/judicial/id/207/>
- Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Raporti vjetor 2022. <https://spak.gov.al/raporti-vjetor>.
- Smejkalová, Terezie. (2020). Importance of judicial decisions as perceived level of relevance. Utrecht Law Review.
- Shehu, Isuf. (2023). Raport monitorimit. Lufta ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar. Qendra Fol.
- Udhëzim Nr. 15, datë 23.12.2021 "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor"
- United Nations Office on Drugs and Crime. (2011). Resource Guide on Strengthening Judicial Integrity and Capacity.
- Urdhër i Ministrit të Drejtësisë. nr.6777/5, datë 30 shtator 2010 për miratimin e Rregullores "Për marrëdhënien e gjykatës me publikun". https://www.gjp.gov.al/Programi_i_Transparences/Rregullore/RREGULLORE_P_R_MARR_DH_NIENEGJYKAT_S_ME_PUBLIKUN.html
- VKM, Nr. 823, datë 24.12.2021 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 dhe të planit të saj të veprimit". https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/VKM-Nr.823-dat%C3%AB-24.12.2021-e-bashkuar_compressed.pdf
- Vrumo, Gjergji et al. (2021). Zbërthimi i kapjes së shtetit në Shqipëri, Në shqyrtim i rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe ligjeve të bëra me porosi nga viti 2008 deri në 2020. Transparenca Ndërkombëtare dhe Insituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

Shtojcat

Shtojca 1: Numri i çështjeve të rregjistruara, përfunduara dhe mbartura nga Gjykatë e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimin e Organizuar

Nenet / Emërtimi i nenit	2021			2022		
	Çështje të regjistruara	Çështje të përfunduara me vendim	Çështje të mbartura në 2022	Çështje të regjistruara	Çështje të përfunduara me vendim	Çështje të mbartura në 2023
78/a; 78/2; 333/a Vrasje për gjakmarrje; Vrasja me paramendim, e kryer për interes, hakmarrje a gjakmarrje	6	1	5	11	3	8
79/a; 79/dh; 333/a Vrasje e funksionareve publik; Vrasje në rrethana të tjera cilësuese - kundër dy ose më shumë personave	4	1	3	4	1	3
109/3; 333/a Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit nën moshën 14 vjeç, i paraprirë a shoqëruar me tortura fizike ose psikike, i kryer kundër disa personave ose më shumë se një herë	1	0	1	1	1	-

134/3; 139; 140; 333/a Vjedhja; Vjedhja me dhunë; Vjedhja me armë	6	3	3	4	2	2
186/2; 186/1; 189/2; 190, 312, 333/a Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara; Falsifikimi i dokumenteve; Përdorimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave të falsifikuara	3	2	1	5	4	1
244 Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	17	16	1	4	1	3
245/1/2 Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike	10	9	1	10	9	1
248 Shpërdorimi i detyrës	6	6	0	9	9	
258 Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike	6	2	4	10	5	5
259 Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	23	19	4	13	4	9
283/a/2; 333/a Trafikimi i narkotikëve, në bashkëpunim ose më shumë se një herë	7	4	3	16	12	4

283/a/1; 333 Trafikimi i narkotikëve	14	10	4	-	-	-
283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve	1	1	-	-	-	-
284/1; 333/a Kultivimi i bimëve narkotike	2	1	1	3	-	3
287/a Çelja e llogarive anonime	1	1	0	2	-	2
298/1; 333/a Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit. Strehimi, shoqërimi, venia në dispozicion e mejteve ose përdorimi i tyre për të ndihmuar kalimin e paligjshëm të kufirit	1	0	1	5	2	3
289/3; 289/2 Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me pasoja të rënda; Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, e dhënë për qëllime fitimi	5	3	2	-	-	-
319/ç Korrupsioni pasiv i gjyqtareve, prokuroreve dhe funksionareve të tjere të organeve të drejtësisë	2	1	1	2	2	-
319 Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë	1	0	1	3	2	1

333/a/1 Grupi i strukturuar kriminal, krijimi, organizimi ose drejtimi	2	1	1	1	-	1
119/1 Fyerja	2	1	1	2	-	2
120/1; 120/2 Shpifja; Shpifja botërisht, në dëm të disa personave, ose më shumë se një herë	24	14	10	24	18	6
257/a/2 Rrefuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë	1	1	0	4	-	4
328/1 Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve	3	1	2	5	2	3
230 Kryerja e veprimeve terroriste	1	1	0	1	1	-
Totali	149	99	50	139	78	61

Burimi: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Kundër korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Analiza vjetore e punës 2021, Analiza vjetore e punës 2021,

Shtojca 2: Numri i procedimeve për vepra penale që lidhen me korrupsionin

Vepra penale	2020						2021						2022					
	Gjyq	Pushuar	Pezulluar	Transferuar	Në hetim	Totali	Gjyq	Pushuar	Pezulluar	Transferuar	Në hetim	Totali	Gjyq	Pushuar	Pezulluar	Transferuar	Në hetim	Totali
Neni 244 Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	25		1	1	3	30	4		3	1	4	12				1	1	2
Neni 244/1 Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike									1	1		2						
Neni 244/2 Korrupsioni aktiv i nënpunësve të huaj publikë													2				1	3
Neni 245 Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë					1	1											3	3

Neni 245/1 Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike				3	12	15	2	1		4	13	20	1			3	16	20
Neni 245/1/1 Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike	1					1												
Neni 245/1/2 Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike	6		2			8	4				2	6	7	2			1	10
Neni 245/1/4 Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike																	4	4
Neni 248 Shpërdorimi i detyrës							7	3		3	77	90	1	3		22	60	86

Neni 258/1 Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike							1					1						
Neni 258/2 Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike											1	1					3	3
Neni 259 Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	16	8		14	60	98	6	3	3	11	60	83	5	4	1	9	59	78
Neni 259/1 Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike							4			3		7	2					2
Neni 259/2 Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike											3	3	5		1	3	5	14
Neni 260 Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë				3	9	12				4	7	11	2	1		1	4	8

Neni 312 Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit				1		1		1				1	1				1	2
Neni 319 Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë		1			4	5				1	9	10					7	7
Neni 319/ç Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë	2	13	1	6	45	67	3	8	1	3	38	53	2	10		3	29	44
Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje							2	7		7	19	35	3	3	3	2	11	22
Neni 328/b Korrupsioni pasiv në zgjedhje								1	1			2					1	1
Gjithsej procedimet për vepra penale që lidhen me korrupsionin	50	22	4	28	134	238	33	24	9	38	235	339	43	30	5	59	285	422

Burimi: Struktura e Posaçme Kundër korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Raporti vjetor 2020, Raporti vjetor 2021, Raporti vjetor 2022

Shtojca 3: Rekomandimet në lidhje me nivelin e përgatitjes dhe përparimit të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (2020-2022)

Viti	Përgatitja	Përparimi	Korrupsioni/ Rekomandime për vitin pasues	Përgatitja	Përparimi	Krimi i organizuar/ Rekomandime për vitin pasues
2022 ¹⁹²	Njëfarë nivel përgatitje	Pak përparim	<ul style="list-style-type: none"> progres i mëtjshëm drejt krijimit të një historie solide të hetimeve, ndjekjes penale dhe gjyqimit të rasteve të korrupsionit, si dhe sekuestrimit dhe konfiskimit/rikuperimit të aseteve kriminale që rezultojnë nga veprat e lidhura me korrupsionin; të sigurojë që Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) të adresojë më tej korrupsionin e nivelit të lartë, të rrisë stafin dhe burimet e saj, si dhe koordinimin e saj me organet ligjzbatuese, të prokurorisë dhe gjyqësore të ngarkuara për parandalimin e korrupsionit; të sigurojë që procedurat penale të nisin në mënyrë të 	Njëfarë nivel përgatitje	Pak përparim	<ul style="list-style-type: none"> të vazhdojë forcimin e luftës kundër krimit të organizuar, duke përfshirë bashkëpunimin me shtetet anëtare të BE-së, si dhe me agjencitë e BE-së, përfshirë Europolin dhe Eurojust-in dhe të rrisë përdorimin proaktiv të Aplikacionit të Sigurt të Rrjetit të Shkëmbimit të Informacionit të Europolit (SIENA) për shkëmbimin e informacionit dhe shtrirjen e tij praktike për agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit; të krijojë pa vonesë një zyrë të rikuperimit të aseteve në përputhje me acquis të BE-së, e cila është përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e

¹⁹² Komisioni Evropian, (2022), Progres Raporti për Shqipërinë 2022, fq. 22, 38.

			<p>vazhdueshme dhe sistematike kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të akuzuar për sjellje kriminale gjatë procesit të rivlerësimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> të adresojë në mënyrë efektive rekomandimet e Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO) dhe të zbatojë në kohë planin e veprimit përkatës; miratimi i planeve të integritetit/parandalimit të korrupsionit brenda të gjitha ministrive të linjës dhe autoriteteve shtetërore. 			<p>aseteve kriminale, siç parashikohet nga legjislacioni kombëtar;</p> <ul style="list-style-type: none"> të sigurojë që Zyra e Prokurorisë Speciale dhe Byroja Kombëtare e Hetimit të vazhdojnë të rrisin aksesin operacional në të gjitha bazat e të dhënave përkatëse.
2021 ¹⁹³	Njëfarë niveli përgatitje	Pak përparim	<ul style="list-style-type: none"> të vazhdojë të forcojë luftën kundër korrupsionit; progres i mëtejshëm drejt krijimit të një historie solide të hetimeve, ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të korrupsionit, sekuestrimit dhe konfiskimit/rekuperimit të aseteve 	Njëfarë niveli përgatitje	Përparim i mirë	<ul style="list-style-type: none"> të vazhdojë forcimin e luftës kundër krimit të organizuar, duke përfshirë bashkëpunimin me shtetet anëtare të BE-së si dhe me agjencitë e BE-së, duke përfshirë EUROPOL-in dhe EUROJUST-in; numri i agjencive shqiptare të

¹⁹³ Komisioni Evropian, (2021), Progres Raporti për Shqipërinë 2021, fq. 23, 36.

		<p>kriminale që rezultojnë nga veprat e lidhura me korrupsionin;</p> <ul style="list-style-type: none"> të sigurojë që Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), d.m.th. Prokuroria e Posaçme (PP), Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH), si dhe Gjykatat e posaçme të trajtojnë efektivisht korrupsionin e nivelit të lartë; të sigurojë burime, aftësi dhe bashkëpunim adekuat ndërmjet këtyre strukturave të reja dhe subjekteve të tjera të ndjekjes penale dhe gjyqësore; të sigurojë që të nisin në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike procedura penale kundër gjyqëtarëve dhe prokurorëve të akuzuar për sjellje kriminale gjatë procesit të rivlerësimit; të adresojë në mënyrë efektive rekomandimet e GRECO-s dhe të zbatojë planin e veprimit përkatës brenda kuadrit kohor.¹⁹⁴ 		<p>zbatimit të ligjit që kanë akses në SIENA duhet të zgjerohet më tej;</p> <ul style="list-style-type: none"> të krijojë pa vonesa ose të caktojë një zyrë/agjenci për rikuperimin e aseteve në përputhje me acquis të BE-së që është përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e aseteve kriminale, siç parashikohet nga legjislacioni kombëtar; të forcojë reagimin efektiv të zbatimit të ligjit ndaj krimin kibernetik për të rritur zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale.
--	--	--	--	--

¹⁹⁴ Komisioni Evropian, (2020), Progres Raporti për Shqipërinë 2020, fq. 23-24, 38-39.

2020	Njëfarë niveli përgatitje	Përparim i mirë	<ul style="list-style-type: none"> të vazhdojë të forcojë luftën kundër korrupsionit; të arrijë përparim të mëtejshëm drejt krijimit të një historiku të qëndrueshëm të çështjeve të korrupsionit, sekuestrimit dhe konfiskimit/rekuperimit të pasurive kriminale të rrjedhura nga veprat e lidhura me korrupsionin; të rrisë më tej përdorimin e hetimeve financiare; të sigurojë që organet e specializuara antikorrupsion të krijuara së fundmi, të bëhen funksionale dhe të trajtojnë në mënyrë efektive korrupsionin e nivelit të lartë; të sigurojë burime të përshtatshme dhe bashkëpunim midis këtyre strukturave të reja dhe me organet e tjera të prokurorisë dhe gjyqësorit; të vazhdojë përmirësimin e aksesit në rregjistrat elektronik kombëtar për autoritetet e zbatimit të ligjit. 	Njëfarë niveli përgatitje	Përparim i mirë	<ul style="list-style-type: none"> të vazhdojë të forcojë luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë përmes bashkëpunimit me shtetet anëtare të BE-së, si dhe EUROPOL-in; të miratojë një strategji të re dhe një plan veprimi për drogën, të mbush hendekun legjislativ për prekursorët e drogës dhe intensifikimin e luftës kundër trafikut të drogës; të miratojë një strategji kundër krimit kibernetik dhe të krijojë një përgjigje më efektive të zbatimit të ligjit, e cila përqëndrohet tek ndalimi, gjurmimi dhe ndjekja penale e kriminelëve kibernetikë dhe të trajtojë fenomenin në rritje të pornografisë së fëmijëve online.
------	---------------------------------	--------------------	--	---------------------------------	--------------------	---

